



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në:

“Mami”

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof. As. Etleva Refatllari
2. Dr. Elda Panariti (Nuni)

Mars/2024

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT Master i Shkencave në “Mami”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Specialiteteve Tekniko-Mjekësore
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Mami”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Ky program studimi është hapur me VKM Nr. 744, datë 05.09.2013 për miratimin e kuotave.
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA nr.80, datë 31.05.2018
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditohet për herë të parë
8	Cikli i studimit:	Cikli i II-të Master i Shkencave
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 (dy) vite akademike
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Nuk ka
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Nuk ka
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Nuk ka
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7-të
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	11 PAE/9PAK
18	Numri i studentëve:	2020-2021- 32 studentë 2021-2022 -18 studentë
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan (UNIEL) është një institucion publik i arsimit të lartë i Liçencuar me VKM 414, datë 03.12.1991 të Ministrisë së Arsimit i cili miratoi kthimin e Institutit të Lartë Pedagogjik në UNIEL. UNIEL është riakredituar me VBA Nr. 49, datë 27.11.2020. UNIEL përbëhet nga pesë fakultete: Fakulteti i Ekonomisë, Fakulteti i Shkencave Humane, Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Fakulteti i Shkencave të Edukimit, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, të cilat e kanë fokusuar veprimtarinë e tyre në shkencat ekonomike, të natyrës, të edukimit, humane dhe mjekësore.

Programi i studimit Master i Shkencave në “Mami” zhvillohet në Departamentin e Specialiteteve Tekniko-Mjekësore pjesë e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike (FSHMT) në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” Elbasan. FSHMT është hapur me urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 187 datë 7.05.2012, dhe përbëhet nga katër njësi bazë: Departamenti i Infemieristikës, Departamenti i Lëndëve Paraklinike, Departamenti i Lëndëve Klinike dhe Departamenti i Specialiteteve Tekniko-Mjekësore.

FSHMT në total ofron 15 programe të ciklit të parë dhe të dytë dhe një program Doktorature.

Programi i studimit Master i Shkencave në “Mami” është hapur me VKM Nr. 744, datë 05.09.2013 për miratimin e kuotave. Programi i studimit MSH “Mami” kategorizohet në nivelin 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Ky program është organizuar dhe strukturuar në përputhje me statusin dhe rregulloren e institucionin, Ligjin 80/2015 për “Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe akteve nënligjore në fuqi për IAL-të.

Programi zhvillohet në bazë të parimeve të lirisë akademike, autonomisë institucionale, cilësisë, efektshmërisë, efijencës dhe vetëfinancimit. Veprimtaria mësimore zhvillohet në bazë të planeve dhe të programeve mësimore bashkëkohore të bazuara në modelet e shkollave analoge europiane. Programi i studimit MSH në “Mami” është hartuar dhe ofrohet në përputhje me planet e zhvillimit strategjik të institucionit dhe ofrohet në përputhje me fushën akademike të FSHMT dhe Departamentit të Specialiteteve Tekniko Mjekësore që është përgjegjës për këtë program studimi.

Programi i studimit MSH në “Mami” synon përgatitjen e specialistëve të aftë për të përballuar sfidat e tregut lokal të punës si dhe krijon premisa për ekuivalentim të programit në tregun rajonal e më gjerë si dhe për kualifikim në programe të niveleve më të larta. Në program ka një harmonizim të mirë të lëndëve të formimit bazë e karakterizues me praktikën profesionale.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Raporti i vlerësimit të jashtëm, është dokument i hartuar në kuadër të akreditimit për herë të parë të programit të studimit Master i Shkencave në “Mami”, i ofruar nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” Elbasan (UNIEL). Ky raport përmbledh procedurën e realizimit të këtij procesi, vlerësimin përkundrejt standardeve dhe kritereve për programin e studimit, pjesë e Kodit të Cilësisë, gjetjet konstatimet dhe vlerësimin për çdo fushë, vlerësimin e përgjithshëm për përmbushjen e standardeve dhe kritereve respektive. [ascal.al]

Vlerësimi i jashtëm është fokusuar në 6 fusha vlerësimi: Ofrimi i programit të studimit; Organizimi, Drejtimi dhe administrimi i programit të studimit; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kompetencat, Burimet njerëzore financiare infrastruktura logjistika për realizimin e programit të studimit; Studentët dhe mbështetja e tyre; Sigurimi i cilësisë në programin e studimit. Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen
- Standardet përmbushen pjesërisht
- Standardet përmbushen kryesisht
- Standardet përmbushen plotësisht

Në mbështetje të hartimit të raportit dhe gjykimeve të arritura janë shqyrtuar një sërë dokumentash dhe informacionesh të vëna në dispozicion nga Institucioni në faza të ndryshme të vlerësimit, nga ASCAL si dhe informacione të publikuara në faqen zyrtare të institucionit.

I gjithë dokumentacioni i referuar, jepet në fund të këtij raporti dhe është i renditur sipas listës numerike të paraqitur në këtë aneks [aneks, lista e evidencave].

Proçesi i vlerësimit është koordinuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit AMS.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është i përbërë nga Prof. Dr. Etleva Refatllari dhe Dr. Elda Panariti (Nuni). Koordinatore Teknike e ASCAL për këtë proces vlerësimi është Msc. Aleksandra Xhamo.

Bazuar në afatet e përcaktuara dhe në procedurën e vlerësimit, proçesi u realizua në disa faza:

- Vlerësimi i brendshëm ku Institucioni ka dorëzuar Dosjen e Vetëvlerësimit, ku përfshihet Raporti i Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacioni mbështetës (DVV). Gjatë kësaj faze janë kërkuar nga ASCAL saktësime dhe plotësime në dokumentacionin e dërguar.
- Shqyrtimi i raportit dhe dokumentacionit, përgatitja e materialeve për vizitën në institucion. Gjatë kësaj faze janë kryer takime dhe diskutime nga ana e GVJ, janë hartuar draftet paraprake, është propozuar agjenda e vlerësimeve dhe lista e pyetjeve të mundshme sipas takimeve respektive.

- Vizita në UNIEL e zhvilluar në datat 6 – 7 Shkurt 2023. Në institucion janë kryer disa takime të rëndësishme me aktorë dhe faktorë të institucionit në funksion të programit të studimit.
- Hartimi i raportit paraprak dhe finalizimi i tij.

Informacionet e mbledhura dhe shqyrtuara në çdo fazë të procesit kanë ndihmuar GVJ të arrijë në konkluzionet e veta mbi nivelin e përmbushjes së standardeve për këtë program studimi. Gjetjet, konstatimet dhe vlerësimet, pasqyrojnë me korrektësi, paanshmëri dhe profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet aktualisht programi i studimit nga ana e UNIEL.

GVJ vlerëson maksimalisht angazhimin e institucionit, Grupit të Vlerësimit të Brendshëm dhe personelin akademik për gadishmërinë e treguar në dhënien e informacioneve të kërkuara në funksion të procesit gjatë vizitës në institucion.

Më datë 14.02.2024, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 39/2 Prot., datë 14.02.2024, dërgohet në institucion Draft-Raportin i Vlerësimit të Jashtëm. IAL, përmes AMS, më datë 23.02.2024, dhe me shkresë zyrtare Nr. 642/130 Prot., datë 23.02.2024, institucioni ka dërguar komente mbi draft raportin.

Pasi shqyrtuam komentet e ardhura nga institucioni ne si ekspertë të jashtëm konkludojmë që institucioni është i dakortësuar me draft raportin e vlerësimit të jashtëm (DRVJ) prandaj gjykojmë që ky draft dërgohet tani nga ana jonë si Raport i Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit Master i Shkencave në “Mami” në Universitetin “Aleksandër Xhuvani” Elbasan.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Mami”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” (UNIEL) është institucion publik i Arsimit të Lartë i krijuar me VKM Nr. 414, datë 12.11.1991. UNIEL ka marrë akreditimin institucional për një periudhë 6 vjeçare me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 49, Datë 27.11.2020.</p> <p>Ky institucion i arsimit të lartë është ngitur mbi eksperiencën 20 vjeçare të Institutit të Lartë Pedagogjik “Aleksandër Xhuvani”. UNIEL ka traditë në mësimdhënie pasi është vazhdues i Shkollës Normale të Elbasanit, i pari institucion kombëtar i përgatitjes së mësuesve në Shqipëri, themeluar më 1909. UNIEL është zhvilluar në vite duke u bërë qëndër universitare e rëndësishme për rajonin. UNIEL bën përpjekje të vazhdueshme që përmes ofrimit të dijeve në nivele bashkëkohore të ruajë dhe konsolidojë vlerat akademike dhe kulturore kombëtare.</p> <p>Universiteti i Elbasanit “Aleksander Xhuvani” deklaron në statut se organizohet dhe funksionon në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, aktet nënligjore dhe legjislacionin në fuqi.</p> <p>Në nenin 2 të statutit të institucionit theksohet se UNIEL ka për mision veç të tjerash <i>të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, duke kontribuar në rritjen e standardeve të demokracisë në vend, të kontribuojë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal, si dhe në forcimin e sigurisë publike dhe kombëtare si dhe të mbeshtesë prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit.</i></p> <p>Programet e studimit të ofruara nga UNIEL janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit kombëtar të arsimit të lartë dhe i përgjigjen interesave kombëtare në fushën e arsimit të lartë.</p> <p><i>(Evidencat 1.1 Statuti i UNIEL, 1.6 Çertifikata e akreditimit institucional, 1.3.1 Strategjia e FSHMT, 1.8 Rregullore e programit të studimit)</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave (MSH) në “Mami” ofrohet nga Departamentin e Specialiteteve Teknike Mjekësore (DSTM), strukturë e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike (FSHMT) të UNIEL. Programi është miratuar si program i ciklit të dytë të studimeve me</p>

<p>institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Vendim Nr.18 të Senatit Akademik të UNIEL, datë 15/03/2013. Programi i studimit MSH “Mami” kategorizohet në nivelin 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.</p> <p>Referuar dokumentacionit mbështetës dhe RVB, GVJ konstaton se programi MSH në “Mami” është hartuar konform misionit dhe qëllimeve të UNIEL dhe fushës së veprimtarisë së FSHMT sipas akteve ligjore dhe akteve rregullatore të IAL. Objektivi kryesor i FSHMT është formimi i profesionistëve të aftë për të përballuar sfidat e zhvillimit në fushat e shkencave mjekësore e teknike. Në rregulloren e programit të studimit theksohet se programi zhvillohet në bazë të parimeve të lirisë akademike, autonomisë institucionale, cilësisë, efektshmërisë, eficiencës dhe vetëfinancimit. Në rregullore deklarohet se veprimtaria mësimore zhvillohet në bazë të planeve dhe të programeve mësimore bashkëkohore të bazuara në modelet e shkollave analoge europiane.</p> <p>(Evidencat 1.1 Statuti i UNIEL, 1.2 Rregullore e studimeve në UNIEL, 1.7 Rregullore e studimeve në FSHMT, 1.8 Rregullore e programit të studimit)</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>UNIEL dhe FSHMT e bazojnë veprimtarinë e tyre në Statutin dhe rregulloret e institucionit. Mbështetur në këto dokumenta bazë të funksionimit të institucionit hartohen rregulloret e programeve të studimit. Programi i studimit MSH në “Mami” është hartuar dhe ofrohet në përputhje me planet e zhvillimit strategjik të institucionit dhe ofrohet në përputhje me fushën akademike të FSHMT dhe Departamentit të Specialiteteve Tekniko Mjekësore që është përgjegjës për këtë program studimi.</p> <p>Në dokumentin e Strategjisë së zhvillimit 4 vjeçar (2020 – 2024) theksohet se FSHMT është dhe synon të mbetet një nga njësitë qendrore më të rëndësishme të UNIEL si dhe të arsimit të lartë publik në Shqipëri. Për realizimin e këtij objekti FSHMT punon për ruajtjen dhe konsolidimin e programeve të studimit që ofron, dhe synon pasurimin e kurrikulës universitare me programe të reja studimi. Zhvillimi do të mbështetet në përmirësimin dhe krijimin e infrastrukturës së përshtatshme, pasurimin e burimeve njerëzore dhe në politika mbështetëse për studentët dhe stafin akademik.</p> <p>(Evidencat 1.1 Statuti i UNIEL, 1.2 Rregullore e studimeve në UNIEL, 1.3 Strategjia e UNIEL, 1.3.1 Strategjia e FSHMT, 1.7 Rregullore e studimeve në FSHMT, 1.8 Rregullore e programit të studimit)</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Programi MSH në “Mami” është hartuar bazuar në ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit, interesin kombëtar, strategjinë e zhvillimit institucional të UNIEL dhe FSHMT, strategjinë kombëtare për punësim dhe arsim, strategjinë kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe informacionin si</p>

	dhe objektivat dhe fushën e veprimtarisë së Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike. (Evidencat 1.3 Strategjia e UNIEL, 1.3.1 Strategjia e FSHMT)			
Konkluzione	GVJ gjykon se Standardi I.1 përmbushet plotësisht. GVJ gjykon se programi i studimit MSH në "Mami" ofrohet në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit dhe në përputhje të plotë me fushën akademike të FSHMT dhe Departamentit të Specialiteteve Teknike Mjekësore që janë përgjegjëse për këtë program studimi. Programi i studimit synon formimin e specialistëve të aftë për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për të ofruar kujdes shëndetësor në fushat e parandalimit, trajtimit dhe edukimit shëndetësor të popullatës. Programi është në përputhje me strategjinë kombëtare në fushën e shëndetësisë dhe synon të përmbushë nevojat specifike për personel të kualifikuar në mami. Ky program bazohet dhe funksionon sipas akteve ligjore dhe akteve rregullatore të IAL.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	UNIEL është riakredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 49, date 27.11.2020 me kohëzgjatje normale 5 vite akademike. Në përbërje të UNIEL janë pesë fakultete që e kanë fokusuar veprimtarinë e tyre në shkencat ekonomike, të natyrës, edukimit, humane dhe mjekësore. Institucioni tashmë ka krijuar profilin e vet në mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përmirësimit gradual të kapaciteteve infrastrukturore që disponon dhe burimeve njerëzore në staf akademik dhe mbështetës. Pas konsultimit të dokumentacionit të dorëzuar, takimit në institucion dhe vizitës në ambientet e laboratorëve, GVJ konstaton se institucioni ka përvojë 10 vjeçare në ofrimin e këtij programi studimi. Në tabelat shoqëruese të RVB si dhe CV e personelit akademik jepet një informacion i detajuar mbi numrin dhe cilësitë e personelit akademik të përfshirë në programin e studimit MSH në "Mami". GVJ evidentoi se institucioni ka kapacitete akademike të mjaftueshme për realizimin e programit të studimit ku shumica e lëndëve/moduleve mbulohej kryesisht nga stafi akademik efektiv. Stafi akademik efektiv realizon mbi 80% të ngarkesës së programit mësimor. FSHMT ka 41 staf akademik efektiv, specialistë në fushën e mjekësisë dhe infermierisë nga të cilët: <ul style="list-style-type: none"> • 2 Profesorë • 3 Profesorë të Asociuar

	<ul style="list-style-type: none"> • 16 Doktorë të Shkencave • 10 me diplomë Master i Shkencave në proces të mbrojtjes së doktoraturës • 10 me diplomë Master i Shkencave <p>Krahasuar me numrin aktual të studentëve të regjistruar dhe që ndjekin studimet, institucioni ka kapacitetet, burimet financiare dhe logjistike që mundësojnë zhvillimin e programit të studimit. GVJ e konsideron pikë të fortë infrastrukturën që disponon institucioni për realizimin e praktikës mësimore: 3 laboratorë mjekësorë me 20 vende ku kryhen procedura infermieristike dhe 3 kabinete praktike me 25 vende me pajisje mjekësore në dispozicion të studentëve, të cilat ndihmojnë në praktikimin e aftësive dhe njohurive të marra nga studentët. Në dispozicion të studentëve janë dhe ambientet e bibliotekës së FSHMT, bibliotekës së UNIEL dhe laboratorit i informatikës.</p> <p>FSHMT është i vendosur në territorin e spitalit rajonal të Elbasanit dhe ka marrëveshje bashkëpunimi me këtë institucion dhe institucione të tjera shëndetësore për zhvillimin e programit të studimit. Për realizimin e praktikës profesionale të studentëve FSHMT dhe UNIEL kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione shëndetësore publike të qarkut të Elbasanit si Spitali Rajonal Elbasan, Spitali Psikiatrik “Dr.Sadik Dinçi”, Elbasan, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Drejtoria Rajonale e Shëndetit Elbasan.</p> <p><i>(Tabelat 1, 6, 7, 8, 16, 17 të RVB, Evidencat 1.13 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit, 1.14 Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikës, 2.15 CV e personelit akademik, vizita dhe takimet në institucion)</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit MSH në “Mami” ofrohet nga Departamenti i Specialiteteve Tekniko-Mjekësore pjesë e Fakultetit Të Shkencave Mjekësore Teknike.</p> <p>FSHMT përbëhet nga katër departamente: Departamenti i Infermieristikës, Departamenti i Lëndëve Paraklinike, Departamenti i Lëndëve Klinike dhe Departamenti i Specialiteteve Tekniko-Mjekësore. FSHMT në total ofron 15 programe të ciklit të parë dhe të dytë dhe një program Doktorature:</p> <p>I. Gjashtë programe në ciklin e parë Bachelor:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Bachelor në “Infermieri përgjithshme” b. Bachelor në “Infermieri Mami” c. Bachelor Teknik Laboratori d. Bachelor Fizioterapi e. Bachelor Teknik Imazherie f. Logopedi <p>II. Dy programe në ciklin Master Shkencor:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Master Shkencor në Infermieri b. Master Shkencor në Mami <p>III. Gjashtë programe në ciklin Master Profesional:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. MP në Teknik Imazherie b. MP në Teknik Laboratori

	<p>c. MP në Logopedi d. MP në Infermieri Kirurgjikale e. MP në Menaxhim Infermieror f. MP në Fizioterapi</p> <p>IV. Një program doktorature</p> <p>Profili i programeve dhe fusha e përgjithshme dhe specifike e tyre përputhet me atë të njësisë kryesore . GVJ vlerëson se Programi MSH në “Mami” është organizuar dhe strukturuar në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të institucionit duke respektuar kërkesat e Ligjit për Arsimin e Lartë dhe aktet nënligjore në fuqi. Klasifikimi/kodifikimi i programit të studimit është kryer sipas direktivave dhe udhëzimeve në fuqi për IAL.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Programi kategorizohet në nivelin 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve • Emërtimi përputhet me fushën specifike të studimit • Strukturohet në 4 semestra akademike (secili me 30 ECTS) • Në ndarjen e lëndëve janë respektuar kriteret ligjore në fuqi (VKM 41 datë 24.01.2018) • Lëndët e programit të studimit janë të koduara sipas përcaktimeve ligjore <p><i>(Evidencat 1.7 Rregullore e FSHMT, 1.8 Rregullore e programit të studimit, 1.9 Pasqyra e kodifikimit të lëndëve të programit të studimit MSH në “Mami”, tabelat 9,10 të RVB Planit mësimor)</i></p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Programi i studimit MSH në “Mami” realizohet në Departamentin e Specialiteteve Tekniko-Mjekësore të FSHMT, fusha e veprimtarisë së të cilit përputhet me atë të programit të studimit. Programi i studimit është ndërtuar mbi bazën e Sistemit Europian të transferimit të krediteve ETCS në përputhje të plotë me statutin e Universitetit dhe legjislacionin shqiptar në fuqi. Programi i studimit zhvillohet në gjuhën shqipe dhe përfshin aktivitete mësimore në fushën e menaxhim dhe organizmit shëndetësor, metodologjinë e kërkimit shkencor, si dhe në shkencën e obstetrikë gjinekologjisë.</p> <p><i>(Evidencat 1.7 Rregullore e FSHMT, 1.8 Rregullorja e programit të studimit, 2.12 syllabuset e programit të studimit, tabelat 9,10 të RVB Planit mësimor)</i></p>
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>Kriteri nuk aplikohet për këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e</p>	<p>Kriteri nuk aplikohet për këtë program studimi.</p>

diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.									
Konkluzione	<p>GVJ gjykon se Standardi I.2 përmbushet plotësisht.</p> <p>UNIEL është një institucion publik i arsimit të lartë me një eksperiencë të gjatë në ofrimin e programeve të studimit të ciklit të parë dhe të dytë. Institucioni ka krijuar profilin e vet në mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përmirësimit gradual të kapaciteteve infrastrukturore që disponon dhe burimeve njerëzore në staf akademik dhe mbështetës.</p> <p>FSHMT përbëhet nga katër departamente : Departamenti i Infemieristikës, Departamenti i Lëndëve Paraklinike, Departamenti i Lëndëve Klinike dhe Departamenti i Specialiteteve Tekniko-Mjekësore. FSHMT në total ofron 15 programe të ciklit të parë dhe të dytë. Programi MSH në "Mami" realizohet në departamentin e Departamentin e Specialiteteve Tekniko-Mjekësore të FSHMT fusha e veprimtarisë së të cilit përputhet me atë të programit të studimit. FSHMT ka staf akademik efektiv në fushën e mjekësisë dhe infermierisë që zotërojnë tituj dhe grada shkencore. Institucioni ka kapacitete infrastrukturore, burimet financiare dhe logjistike që mundësojnë zhvillimin e programit të studimit. Për realizimin e praktikës profesionale të studentëve FSHMT dhe UNIEL kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione shëndetësore publike të qarkut të Elbasanit.</p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi I.3	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisë profesionale, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	<p>Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike në UNIEL ofron 14 programe studimi të ciklit të parë dhe të dytë në fushën e kujdesit shëndetësor. Departamenti i Specialiteteve Tekniko-Mjekësore në FSHMT ofron 2 programe studimi të ciklit të dytë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • MSH në "Infermieri" • MSH në "Mami" • Për realizimin e programit të studimit MSH në "Mami" janë përfshirë PAE dhe PAK. Në realizimin e programit të studimit përfshihen dhe stafi ndihmës dhe administrativ i UNIEL. Organizimi i strukturave realizuese të programit është piramidial dhe funksionon me parimin e bashkëpunimit dhe kontrollit. <p>GVJ u njoh me dokumentacionin e gjerë të vënë në dispozicion mbi aktet rregullatore për ndarjen e detyrave dhe funksionimin e personelit</p>

	<p>akademik, administrativ dhe ndihmës në funksion të programit të studimit.</p> <p>Për të siguruar mbarëvajtjen dhe koordinimin e veprimtarive të këtij programi studimi, me vendim departamenti është caktuar Koordinatori i programit të studimit.</p> <p>Për realizimin e procedurave të ndryshme vlerësuese, projekteve, hartimin e buxhetit, rekrutimin e stafit akademik etj. funksionojnë grupet “ad hoc” në përbërje të të cilit janë anëtarë të stafit akademik të departamentit të infermierisë ose të departamenteve të tjera të FSHMT. Në fillim të çdo viti akademik, dekanati koordinon orarin mësimor dhe ngarkesës mësimore të stafit akademik midis njësive bazë të FSHMT apo departamenteve të lëndëve jo mjekësore si dhe të institucioneve shëndetësore ku realizohet praktika profesionale në funksion të realizimit të programit mësimor në këtë program studimi.</p> <p>Institucioni bën analizë të vazhdueshme të punës që pasqyrohet në Raportin vjetor të Departamenteve dhe raportin vjetor institucional. NJSBC jep kontribut në analizën e vazhdueshme të punës përmes grumbullimit dhe analizimit të informacionit mbi aspekte të ndryshme të aktivitetit akademik.</p> <p>Në takimin me stafin, pedagogët referuan që janë të përfshirë në procedurat vlerësuese e përmirësuese të syllabuseve, si dhe në hartimin e aplikimin e projekteve kërkimore shkencore.</p> <p><i>(Evidencat 1.7 Rregullore e FSHMT, 1.7.1 Rregullore e Departamentit të Specialiteteve Tekniko-Mjekësore, 1.8 Rregullore e Programit të studimit, 1.12 Analiza vjetore institucionale dhe e Departamentit të Specialiteteve Tekniko-Mjekësore, 2.10 Vendim për caktimin e Koordinatorit të Programit të studimit, Takimi me stafin dhe NJSBC)</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Për realizimin e objektivave të procesit mësimor e formues të programit MSH në “Mami”, institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe universitare brenda vendit, institucione spitalore dhe të kujdesit shëndetësor primar, si dhe institucione homologe jashtë vendit në kuadër të programit Erasmus+.</p> <p>Përmes këtyre marrëveshjeve institucioni ka mundur:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Realizimin e praktikës profesionale për studentët • Realizimin e temave të diplomave • Mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve • Realizimin e trajnimeve profesionale • Pjesëmarrjenë projekte kryesisht për ngritjen e kapaciteteve • Realizimin e konferencave të përbashkëta <p>Në analizën vjetore institucionale janë paraqitur në mënyrë të detajuar marrëveshjet, mobiliteti i stafit dhe studentëve si dhe aktivitetet e realizuara në kuadër të marrëveshjeve. <i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstatoi se ka përfunduar afati ligjor i marrëveshjeve dhe duhet të rinovohen.</i></p>

	<p><i>Rekomandim: GVJ rekomandon rinovimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit midis UNIEL dhe institucioneve shëndetësore.</i></p> <p><i>(Tabela 5 e RVB, Evidencat 1.12 Analiza vjetore institucionale, 1.12.1 Analiza vjetore e departamentit të Specialiteteve Tekniko-Mjekësore, 1.13 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit, 1.14 Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave)</i></p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Programi MSH në “Mami” është një program i dedikuar i kujdesit shëndetësor që pais studentin me aftësi për ndërhyrje terapeutike, rehabilituese e parandaluese në obstetrikë-gjinekologji, neonatologji etj. Programi i aftëson studentët dhe në metodologji të kërkimit shkencor dhe menaxhim shëndetësor. Në funksion të realizimit të praktikës shumëplanëshe në funksion të programit institucioni ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi me:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Qendrën Spitalore Xhaferr Kongoli, Elbasan • Spitalin Psikiatrik Sadik Dinçi, Elbasan • Drejtorinë Rajonale të Shëndetit, Elbasan • Qendrën sociale Balashe, Elbasan • Njësitë vendore të kujdesit shëndetësor <p>Prania fizike e FSHMT në mjediset e Spitalit Rajonal të Elbasanit, përfshirja e një numri mjekësh dhe personeli infermieror si PAK për mbikëqyrjen e praktikës në vendin e punës rrit mundësinë e aftësisë praktik të studentëve për të fituar shprehje profesionale.</p> <p>Rregullorja e programit të studimit vendos kushtet që duhet të plotësojë studentin për realizimin e praktikës. Syllabuset e praktikës janë të detajuara.</p> <p>Në diskutimin me stafin akademik u informuam se vlerësimi i praktikës përfshin komponentët e formimit të përgjithshëm teoriko-praktik por dhe komponentë të lidhur me sjelljen, bashkëpunimin dhe përgjegjshmërinë.</p> <p><i>(Tabela 5 e RVB, Evidencat 1.12 Analiza vjetore institucionale, 1.12.1 Analiza vjetore e departamentit të Specialiteteve Tekniko-Mjekësore, 1.13 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit, 1.14 Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave 1.14.1 Paketa e praktikës, Takimet në institucion)</i></p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Në mënyrë periodike, njësia kryesore, përgjegjëse e programit të studimit harton raporte analitike për përfitimin nga marrëveshjet e bashkëpunimit. Ky raport siguron informacion lidhur me ndikimin e këtyre marrëveshjeve në bashkëpunimin midis personelit akademik dhe studentëve për shkëmbim eksperience, kërkim shkencor, mobilitet etj. Të dhënat e raporteve shërbejnë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, hartimin e politikave të zhvillimit me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</p> <p><i>(Evidencat 1.12 Analiza vjetore institucionale, 1.12.1 Analiza vjetore e departamentit të Specialiteteve Tekniko-Mjekësore)</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ gjykon se Standardi I.2 përmbushet plotësisht.</i></p>

	<p><i>Institucioni ka siguruar marrëdhënie bashkëpunimi me institucione shëndetësore lokale përmes të cilave siguron realizimin e praktikave klinike për studentët e këtij programi studimi me qëllim përgatitjen e specialistëve në fushën e mamisë të aftë për të shërbyer në komunitet në parandalim, kurim, edukim shëndetësor etj.</i></p> <p><i>Institucioni ka lidhur një numër të madh marrëveshjes me institucione universitare europiane që i shërbejnë jo vetëm aftësimit profesional të stafit por janë dhe në funksion të kërkimit shkencor dhe mobilitetit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit MSH në “Mami” është ndërtuar në përputhje dhe në harmoni me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për arsimin e lartë në Shqipëri. Programi është i organizuar në lëndë, module dhe vlerësohet me kredite sipas Sistemit Europian të transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) në përputhje me statutin e universitetit.</p> <p>Referuar rregullores së programit të studimit, planit mësimor dhe RVB:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Programi MSH në “Mami” është program i ciklit të dytë të studimeve dhe korrespondon me Nivelin 7 të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve. • Programi i studimit është organizuar në lëndë/module sipas kriterëve ligjore në fuqi: ligji i arsimit të lartë 80/2015 dhe VKM nr.41 datë 24.01.2018. • Programi organizohet në formën e studimit me kohë të plotë. • Kohëzgjatja e studimeve është 2 vite akademike/4 semestra. • Vlerësimi në kredite: 120 ECTS (3000 orë) të ndara 60 ECTS për vit akademik (1500 orë). • 1 ECTS = 25 orë mësimore dhe punë e pavarur e studentit.

- Raporti ECTS:orë është 1 ECTS = 25 orë (Raporti 7.5 - 10/15 – 17.5 orë në auditor/orë studimi individual). Kohëzgjatja e orëve të mësimit është 50 minuta.
- Programi i studimit është i organizuar në lëndë/module të ndara në kategori dhe të prezantuara në planin mësimor dhe tabelat e RVB.
 - Viti I: 14 lëndë të organizuara në 12 module teorike + praktikë profesionale
 - Viti II: 12 lëndë të organizuara në 8 module teorike + praktikë profesionale + Mikroteza
- Proçesi mësimor në auditor përmban elementë të mësimit teorik, (leksione, seminare) dhe praktik (laboratorë, praktikë profesionale). Referuar llogaritjeve në planin mësimor, orët totale janë 3500

MSH në “Mami”	Në total
Në auditor	
- Leksione	636
- Seminare	156
- Laboratore	-
- Praktika profesionale	320
- Prova finale	30
Punë e pavarur e studentit	1858
Gjithsej	3000

- Programi i studimit përbëhet nga veprimtari formuese, të cilat realizohen me kredite ECTS dhe janë të grupuara në:
 - Lëndë bazë 9 ECTS (7,5%)
 - Lëndë karakterizuese 57 ECTS (47.5%)
 - Lëndë ndërdisiplinore/ integruese 20 ECTS (16.65%)
 - Lëndë plotësuese 16 ECTS (13.35%)
 - Detyrime përmbyllëse dhe diploma 18 ECTS (15%)

GVJ konstaton se shpërndarja e lëndëve të programit të studimit në veprimtari formuese sipas kategorive A, B, C, D, E në ECTS/përqindje nuk përputhet me ato të parashikuara në VKM nr 41/2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë dhe të paraqitura më poshtë:

- Lëndë bazë 5 – 10%
- Lëndë karakterizuese 50 – 60%
- Lëndë ndërdisiplinore/ integruese 12 – 20%
- Lëndë plotësuese 10%
- Detyrime përmbyllëse dhe diploma 10 – 15%

Bazuar në këtë VKM për qindja e lëndëve të kategorisë A+B nuk duhet të jetë më pak se 60%. Në këtë program studimi këto dy kategori përbëjnë 55%.

	<p>Rekomandim: GVJ rekomandon rishikohen shëprndarja e ECTSve të lëndëve në kategori duke respektuar peshën e tyre sipas VKM Nr 41/2018.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Frekuentimi i orëve është i detyrueshëm në masën 80% për orët në auditor (leksione, seminare) dhe 100% për orët e laboratorëve dhe praktikave. • Çdo semestër ka 15 javë (12 javë mësimore dhe 3 javë praktikë profesionale). • Viti akademik ka 3 sezone provimi: i dimrit-pas përfundimit të semestrit të parë, i verës-pas përfundimit të semestrit të dytë, i vjeshtës-pas pushimeve verore. Rregullorja lejon dhe organizimin e sezoneve të posaçme të provimeve nga dekanatet me propozim të njësisë bazë dhe me miratim të rektoratit. • Programi i studimit mbyllet temë diplome. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet procedura dhe kriteret e vlerësimit të mikrotezës. (<i>Evidencat 1.8 Rregullore e programit të studimit, 2.9 Plani mësimor i programit të studimit, 2.15 Syllabuset, Tabelat e RVB</i>)
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i studimit synon formimin e specialistëve kompetentë për të përbushur nevojat dhe kërkesat e profesionit në mjedisin dinamik të shërbimit shëndetësor komunitar përmes ofrimit të ekspertizës në fushën e Mamisë. Programi i pajis studentët me njohuri të përgjithshme dhe specifike teorike dhe praktike për të përballuar sfidat e tregut të punës. Programi i studimit MSH në “Mami” realizohet në 26 lëndë/module të cilat ofrojnë informacion teoriko-praktik të gjerë në fushën e infermierisë dhe mamisë. Në vitin e parë të studimit ka një ndërthurje të njohurive të formimit të përgjithshëm në metodologji të kërkimit shkencor, etikë dhe legjislacion, psikologji klinike me lëndë karakterizuese të profesionit si fizipatologjia e obstetrikë gjinekologjisë dhe lëndët e kujdesit infermieror në aspekte të ndryshme obstetrikë-gjinekologjisë. Në vitin e dytë informacioni teorikopraktik fokusohet në lëndë të formimit specifik në kirurgji, anestezi-rianimacion etj. Për një formim të gjithanshëm dhe krijim të shprehive organizuese në semestrin e dytë të vitit të dytë është planifikuar dhe lënda e menaxhimit shëndetësor. Bie në sy fakti që në semestrin e dytë i lihet studentit hapësirë më e madhe për punë të pavarur për përgatitjen e mikrotezës.</p> <p>Një vend të rëndësishëm në programin mësimor ze praktika profesionale (tre javë në çdo semestër) e cila i krijon mundësi studentit të ballafaqojë njohuritë e marra në auditor me realitetin praktik diagnostik. Programi ka si mision të prezantojë studentët me aktivitete direkte në rastet e parandalimit, kurimit, rehabilitimit dhe procedurave të vlerësimeve funksionale.</p> <p>Programi në tërësi jep njohuri të përparuara në fushën e studimit dhe përgatit specialistë që konkurojnë denjësisht në tregun e punës kombëtar dhe ndërkombëtar.</p>

	<p>Programi i studimit ka një ndërthurje harmonike të koncepteve teorike me praktikën në auditor dhe praktikën profesionale. Përmes kësaj ndërthurjeje, programi zhvillon tek studentët aftësi dhe kompetenca profesionale të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse kryesisht në fushën e mamisë. Studentët që diplomohen në këtë program studimi janë të aftë të punojnë në konsultore, dhe në shërbimet spitalore në sektorin e obstetrikë-gjinekologjisë.</p> <p>(Evidencat 1.8 Rregullore e programit të studimit, 2.9 Plani mësimor i programit të studimit, 2.15 Syllabuset, Tabelat e RVB)</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi i studimit Master i Shkencave në “Mami” është i organizuar me kohë të plotë në dy vite akademik të ndarë në katër semestra në total 120 ECTS. Programi ka të përcaktuar qartë ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. Në planin mësimor konstatohet se praktika profesionale shpërndahet në mënyrë proporcionale në të dy vitet e studimit dhe në të 4 semestrat (tre javë çdo semestër).</p> <ul style="list-style-type: none"> • Në vitin e parë 8 ECTS (160 orë praktikë e mbikqyrur/40 orë punë e pavarur) • Në vitin e dytë 8 ECTS (160 orë praktikë e mbikqyrur/40 orë punë e pavarur) <p>Praktika profesionale realizohet në institucionet shëndetësore me të cilat UNIEL ka marrëveshje bashkëpunimi dhe mbikëqyret nga një pedagog dhe një staf nga institucioni ku kryhet praktika. Vlerësimi bëhet nga pedagogu mbikëqyrës. Programi ka një rregullore të shkruar mbi organizimin e praktikës profesionale dhe vlerësimin e studentëve për praktikën. Në fund të praktikë studentët vlerësohen me provim përkatës. Detyrimet përmbyllëse kanë 18 ECTS. Programi mbyllet me mbrojtjen e një mikroteze (diplomë) për të cilën në planin mësimor janë përcaktuar 450 orë prej të cilave 30 orë në auditor dhe 420 orë pune të pavarur. Në kreun IV, V dhe VI të rregullores së programit të studimit dhe në Manualin e punimit të diplomës përcaktohen qartë kushtet e diplomimit, mënyra e organizimit të mbrojtjes së temës së diplomës.</p> <p>(Evidencat 1.8 Rregullore e programit të studimit, 2.9 Plani mësimor i programit të studimit, 2.15 Syllabuset, 3.5 Manuali i punimit të diplomës, Tabelat 9, 10 të RVB)</p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>Kriteri nuk aplikohet për këtë program studimi.</p>

<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>Kriteri nuk aplikohet për këtë program studimi.</p>
<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Në statutin e UNIEL përcaktohet qartë që pranimi dhe regjistrimi i studentëve në programet e studimit të UNIEL bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kapacitetet pritëse dhe kuotat e pranimit për çdo program studimi përcaktohen me vendim senati. Programi i studimit MSH në “Mami” organizohet dhe financohet bazuar në ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore të këtij ligji. Kriteret për pranimin e studentëve në programin e studimit si dhe kuotat e pranimit miratohen me vendim të senatit akademik të universitetit.</p> <p>UNIEL aplikon sistem financimi për student të kategorive të veçanta dhe studentët e ekselencës mbështetur dhe në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe VKM 780, datë 26.12.2018. Në takimin me studentët u informuam që institucioni ka aplikuar në këtë program studimi bursa me karakter social por dhe bursa për studentët e ekselencës.</p> <p><i>(Evidencat 1.8 Rregullorja e programit të studimit, 1.8.1 Vendim për miratimin e kriterëve të pranimit për programin e studimit, 1.8.2 Vendim për miratimin e kuotave të pranimit për programin e studimit, 5.2 Vendim i Bordit të administrimit për bursat dhe përjashtimet, Takimi me studentët)</i></p>
<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtësë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Programi i studimit MSH në “Mami” realizohet në DSMT të Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike në përputhje me misionin dhe objektivat e këtij institucioni. Në RVB deklarohet se programi është i ngjashëm me programin «Master i Shkencave në ‘Mami’» të FSHMT të Universitetit Mjekësor të Tiranës si dhe programe të ngjashme në Universitete të Kosovës dhe Maqedonisë. Ky fakt u theksua gjatë takimit me stafin drejtues të FSHMT por nuk ka dokumentacion që e vërteton këtë ngjashmëri.</p> <p><i>(Evidencat 1.15 Korniza konceptuale e programit të studimit, 2.9 Plani mësimor).</i></p>
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej</p>	<p>Programi i studimit është kodifikuar sipas fushës së studimit nga MASR në vitin 2018. Programi i studimit MSH në “Mami” ka një numër unik të diplomave të regjistruar nga MASR (Nr. Unik i identifikimit 001693). Për këtë program studimi është kryer dhe kodifikimi i lëndëve i cili pasqyrohet në dokumentat e planit mësimor.</p>

kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	<i>(Evidencat 1.15 Korniza konceptuale e programit të studimit, 1.9 Kodifikimi i lëndëve të programit të studimit, Plani mësimor)</i>			
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Kriteri nuk aplikohet për këtë program studimi.			
Konkluzione	<p><i>GVJ gjykon se standarti II.1 përmbushet kryesisht. Programi i studimit MSH në "Mami" është ndërtuar në përputhje dhe në harmoni me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për arsimin e lartë në Shqipëri. Programi është i organizuar në lëndë, module dhe vlerësohet me kredite sipas Sistemit Europian të transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) në përputhje me statutin e universitetit. Programi i studimit synon formimin e specialistëve kompetentë për të përmbushur nevojat dhe kërkesat e profesionit në mjedisin dinamik të shërbimit shëndetësor komunitar përmes ofrimit të ekspertizës në fushën e Infermieri Mami. Programi i pajis studentët me njohuri të përgjithshme dhe specifike teorike dhe praktike për të përballuar sfidat e tregut të punës. Pranimi, regjistrimi i studentëve dhe financimi në programet e studimit të UNIEL bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kapacitetet pritëse dhe kuotat e pranimit për çdo program studimi përcaktohen me vendim senati.</i></p> <p><i>Programi është i kodifikuar dhe krijon mundësi për mobilitet dhe ndjekje të mëtejshme të studimeve të ciklit të dytë.</i></p> <p><i>GVJ konstaton se ndarja sipas veprimtarive formuese ka shmangie nga Tabela 1 e Shtojcës 1 të VKM Nr.41. GVJ rekomandon rishikimin e shpërndarjes së veprimtarive në përshtatje të plotë me udhëzimin e mësipërm.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike në UNIEL që ofron programin e studimit MSH në "Mami" përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p> <p>UNIEL është organizuar bazuar në ligjin Nr. 80/2015, date 22.07.2015 "Për Arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe Statutin e tij dhe zhvillon aktivitetin e tij në selinë në Elbasan. Institucioni përbëhet nga organet</p>

akademike që janë senati akademik, asambleja e stafit akademik, komisionet e përhershme dhe autoritet akademik (rektori, dekanët, drejtuesit e njësisë bazë); organe administrative që janë bordi i administrimit, administratori i universitetit, njësive kryesore; organe kolegjiale që janë këshilli i rektoratit, këshilli i dekanatit, këshilli etikës. UNIEL ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në vitin 2009 dhe riakredituar në nivel institucional në vitin 2017 me vendim të BA nr.49, datë 27.11.2020, për një periudhë 6 vjeçare. Programet e studimit që ofron institucioni janë në proces akreditimi.

Fakulteti i Shkencave Mjekësore teknike në UNIEL që ofron programin e studimit MSH në "Mami" përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. FSHMT përbëhet nga 4 Departamente si më poshtë:

- Departamenti i Infermieristikës
- Departamenti i Lëndëve Klinike
- Departamenti i Lëndëve Paraklinike
- Departamenti i Specialiteteve Tekniko Mjekësore

Njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit është Departamenti i Specialiteteve Tekniko-Mjekësore. Referuar tabelave 1 dhe 2 të RVB, në vitin akademik 2021 – 2022, njësia bazë përbëhet nga **8 anëtarë PAE** dhe përfshin në mësimdhënie dhe **25 anëtarë PAK**. Kualifikimi i personelit akademik të përfshirë në mësimdhënie është:

PAE	PAK
Tituj/Grada	Tituj/Grada
(3) Prof. Asc.	
(2) Dr	(3) Dr
(2) Dr ne proces	(22) Msc
(1) Msc	

PAK janë personel të angazhuar me kohë të plotë në institucionet mjekësore (Qendra spitalore apo shëndetësore) ku studentët kryejnë aktivitetin e praktikave profesionale.

Lidhur me treguesit e moshës pjesën më e madhe të stafit akademik të përfshirë në mësimdhënie që kanë tituj akademikë dhe gradë shkencore doktor i përkasin grup moshës relativisht të re 35-55 vjeç. Nga analiza e tabelave mbi shpërndarjen e ngarkesës mësimore të programit rezulton se rreth 80% e ngarkesës përballohet nga PAE.

(Evidencat 1.1 Statuti i UNIEL, 1.11, Struktura organizative, 1.3.1 Strategjia e FSHMT, 1.7.1 Rregullore e departamentit, Tabelat 1, 2 dhe 8 të RVB, CV e stafit akademik)

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave

FSHMT dhe Departamenti i Specialiteteve Tekniko-Mjekësore kanë angazhuar në këtë program studimi dhe 2 staf ndihmës akademik (Msc) që asistojnë studentët në realizimin e punëve laboratorike në mjediset e institucionit.

Në funksion të programit të studimit janë dhe personeli administrative dhe ndihmës teknik. Grupi i vlerësimit u njoh me stafin ndihmës

mësimore, laboratorike e klinike, etj.	administrativ dhe teknik dhe konstatoi se ky staf i përmbush kriteret e kualifikimit dhe profesionalizmit që kërkohet në këto pozicione punë. <i>(Tabelat e RVB, takimet në institucion)</i>			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Programi ka një koordinator të emëruar nga përgjegjësi i departamentit i cili është staf akademik me kohë të plotë që ka formimin dhe kualifikimin e duhur për të kryer këtë funksion. Koordinatori i programit përgjigjet për organizimin dhe realizimin e programit mësimor dhe praktikës profesionale, përgatitjen e strategjisë dhe rregullores sipas një formati të miratuar dhe raporton rregullisht tek përgjegjësi i departamentit. Koordinatori akademik përgjigjet dhe për ndarjen e organizimin e praktikave sipas shërbimeve shëndetësore dhe ndarjen e studentëve në to. Institucioni dëshmon angazhim serioz të personelit mësimor-shkencor me kohë të plotë, për mbikëqyrjen e studentëve gjatë kryerjes së praktikës profesionale jashtë auditorit dhe mirëmbajtjen e mjediseve laboratorike dhe shkollore. Kjo u konstatua gjatë vizitës në institucion të grupit të vlerësimit dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit shkresor. <i>(Evidencat 2.10 Vendimi për caktimin e koordinatorit të programit të studimit, 2.11 Përshkrimi i detyrave të koordinatorit të programit, Takimet në institucion)</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se kriteri II.2 përmbushet plotësisht. <i>UNIEL, FSHMT dhe Departamenti i Specialiteteve Tekniko-Mjekësore që ofrojnë programin e studimit Master i Shkencave në "Mami" përmbushin kërkesat ligjore dhe standartet e cilësisë për ofrimin e tij. Stafi akademik përbëhet nga një numër optimal pedagogësh PAE dhe PAK, me moshë relativisht të, re me grada e tituj ose në proces për marrjen e tyre. Në funksion të programit të studimit institucioni ka angazhuar dhe personel ndihmës akademik, personelin administrativ dhe ndihmës. Në përmbushje të kërkesave ligjore departamenti ka caktuar dhe një koordinator përgjegjës për programin e studimit që veç të tjerash siguron lidhjen dhe shpërndarjen harmonike të studentëve në institucionet e kryerjes së praktikës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për	Fakulteti i Shkencave Teknike Mjekësore dhe Departamenti i Specialiteteve Tekniko-Mjekësore në UNIEL që ofrojnë programin e

<p>organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>studimit MSH në “Mami” disponojnë gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p> <p>Në dosjen e programit që GVJ ka në dispozicion kemi gjetur informacionin për institucionin dhe për strukturën e programit të studimit, informacion për strukturën akademike përgjegjëse dhe strukturat bashkëpunuese, kuadrin e përgjithshëm formues të programit, të dhënat për personelin akademik për realizimin e programit, planin mësimor, të dhëna për infrastrukturën në dispozicion të programit, kriteret e pranimit, rregulloren e programit, syllabuset e lëndëve dhe suplementin i diplomës.</p> <p>Me fillimin e vitit akademik programi i studimit dhe syllabuset ju vihen në dispozicion studentëve që ndjekin këtë program studimi.</p> <p>Në takimin me stafin dhe drejtuesit e institucionit u informuam për përfshirjen aktive të stafit në përgatitjen e RVB dhe hartimin e dokumentacionit bazë dhe mbështetës për procesin e akreditimit.</p> <p>(Dosja e programit të studimit, takimet në institucion)</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi i studimit MSH në “Mami” është i organizuar në lëndë /module dhe praktikë mësimore në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p> <p>Në planin mësimor detajohet tipi i veprimtarisë formuese në auditor për secilën lëndë (leksione, seminare, ushtrime, laboratore, praktika mësimore).</p> <p>Për secilën lëndë jepet informacion i detajuar për kreditet, totalin e orëve dhe ndarjen e tyre në orë në auditor/orë studimi individual. Jepet gjithashtu informacion për ndarjen e orëve në auditor në leksione, seminare, ushtrime, laboratorë, projekte dhe praktika.</p> <p>Programi zhvillohet në 2 vite akademike, 4 semestra dhe ka në total 120 ECTS ose 3000 orë mësimore prej të cilave 1142 orë në auditor dhe 1858 orë studimi individual.</p> <p>GVJ gjykon se raportet e veprimtarive formuese në auditor janë të arsyetuara sipas tipologjisë së lëndës.</p> <p>(Tabelat 9, 10 të RVB, Plani mësimor)</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Në takimet me sekretarinë mësimore dhe studentët, GVJ konstatoi se institucioni vë në dispozicion të studentëve informacionin e plotë dhe të përditësuar për kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Institucioni aplikon kriteret specifike të pranimit që vendosen me VKM dhe rregulloren e UNIEL.</p> <p>FSHMT propozon kriteret dhe kuotat e pranimit, kuotat e transferimit etj. mbështetur në kapacitetet pritëse dhe akademike të cilat miratohen nga senati akademik dhe dërgohen në QSHA. Informacioni bëhet publikohet në faqen zyrtare on line të UNIEL dhe në portalin U-Albania.</p> <p>Institucioni nxjerr njoftime për pranimin ku përshkruhet procedura e aplikimit, testimit, shpalljes së fituesve dhe regjistrimit.</p> <p>Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet mënyra e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Informacioni gjendet dhe në web site të UNIEL.</p>

	<i>(Evidencat 1.1 Statuti i UNIEL, 1.8 Rregullore e programit të studimit, 1.8.1/1.8.2 Vendime për miratimin e kuotave dhe kriterëve të pranimit, Faqja Web, Takimet në institucion)</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikant, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	<p>Programi i studimit MSH në “Mami” përmban syllabuset e detajuara për secilën lëndë. Syllabuset janë formatuar në përputhje të plotë me kërkesat e VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Syllabuset janë të firmosura nga titullari i lëndës. <i>Bie në sy fakti që disa nga titullarët e lëndëve nuk janë të kategorisë Profesor (kërkesë e ligjit të arsimit të lartë). Një pjesë e madhe e titullarëve kanë të njëjtin nivel kualifikimi me programin Master Shkencor. GVJ rekomandon rishikimin e titullarëve të lëndëve dhe përshtatjen e kategorisë së tyre sipas kërkesave ligjore.</i></p> <p>Në syllabuse gjendet i detajuar informacioni për tipologjinë e lëndës, kreditet, shpërndarjen e orëve në auditor dhe jashtë tij, vitin dhe semestrin në të cilin zhvillohet lënda. Syllabusi jep informacion për lëndën, objektivat dhe rezultatet e pritshme. Temat, literatura referuese dhe formatet e mësimdhënies janë detajuar sipas javëve. Çdo syllabus ka informacion për frekuentimin dhe mënyrën e kontrollit të dijeve. Në syllabuse është specifikuar literatura bazë dhe literatura e rekomanduar. <i>GVJ rekomandon përditësimin e literaturës në disa prej syllabuseve.</i></p> <p><i>(Evidencat 2.9/2.12 Plani mësimor dhe Syllabuset e lëndëve)</i></p>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	<p>GVJ konstaton se programet e studimit në UNIEL janë në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Programi MSH në “Mami” është organizuar sipas kërkesave të VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Programi dhe syllabuset e përditësuara miratohen dhe arkivohen në departament çdo fillim viti. Synohet përmirësim i programit në përmbajtje, literaturë e veçanërisht në implementim të metodologjive të reja mësimdhënëse të mundësuar dhe nga investimet në mjete audiovizive në auditorë si dhe investimet në laboratorë.</p> <p><i>(Evidencat 1.12.1/1.12.2 Analiza vjetore e Departamentit, Raporti për veprimtarinë e programit të studimit, takimi me stafin në institucion)</i></p>
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se Standardi II.3 përmbushet kryesisht</i></p> <p><i>Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë. Synohet përmirësim i programit në përmbajtje, literaturë e veçanërisht në implementim të metodologjive të reja mësimdhënëse të mundësuar dhe nga investimet në mjete audiovizive në auditorë si dhe investimet në laboratorë.</i></p> <p><i>Nga analiza e dokumentacionit GVJ konstatoi që disa nga titullarët e lëndëve nuk janë të kategorisë Profesor (kërkesë e ligjit të arsimit të lartë). Një pjesë e madhe e titullarëve kanë të njëjtin nivel kualifikimi me programin Master Shkencor. GVJ rekomandon rishikimin e titullarëve të</i></p>

	lëndëve dhe përshtatjen e kategorisë së tyre sipas kërkesave ligjore. Po ashtu në disa prej syllabuseve duhet përditësuar literatura.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Programi është hartuar dhe emërtuar në mënyrë të tillë që u shërben studentëve për të thelluar dijet e tyre profesionale teorike dhe praktike në fusha të veçanta dhe të specializuara të obstetrikë – gjinekologjisë të përshtatura me kërkesat e tregut të punës. Në programin e studimit i jepet rëndësi e veçantë formimit praktik profesional të studentit. Orët e praktikës profesionale pranë shërbimeve klinike përbëjnë 28 % të orëve në auditor. <i>(Tabelat 9, 10 të RVB, Plani mësimor)</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.	Organizimi dhe zhvillimi i programit mësimor, shpërndarja e ngarkesës mësimore orë/ECTS ju mundëson studentëve arritjen e objektivave të programit, marrjen e rezultateve dhe fitimin e aftësive të nevojshme profesionale. Me njohuritë e marra në këtë program, studentët e ndjejnë veten të aftë në vendet e tyre të punës dhe dijet e marra janë në funksion të plotë të veprimtarisë së përditshme të tyre. Lëndët dhe praktika në program si dhe ngarkesa e tyre në kredite/orë mësimore përputhet me profilin e programit të studimit MSH në “Mami”. Në vitin e parë zhvillohen lëndë të formimit të përgjithshëm dhe bazë në obstetrikë-gjinekologji. Në vitin e dytë zhvillohen lëndë të formimit profesional sipas specialiteteve kirurgji, gjinekologji invazive, shëndet riprodhues etj. Numrin më të madh të krediteve e kanë lëndët e formimit karakterizues/profesional. (57ECTS/47.5%) Studentët kanë mundësi të aftësohen me shprehitë profesionale praktike gjatë zhvillimit të praktikave klinike mësimore nëpërmjet simulimeve në <i>role playing</i> gjatë lëndëve klinike të realizuara në laboratorin e infermieristikës, laboratorin dixhital të anatomisë, etj. Studentët përmes programit përgatiten dhe me aftësi menaxheriale dhe me nocione të kërkimit shkencor. Në programin mësimor studentët në fund të çdo semestri zhvillojnë praktikën profesionale nga 3 javë/semestër pranë shërbimeve klinike spitalore bazuar në marrëveshjet që ka UNIAL me strukturat shëndetësore spitalore. Studenti gjatë praktikës profesionale përballet me ambientin spitalor si profesionist i kujdesit shëndetësor.

<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>(Evidenca 2.9 Plani mësimor)</p> <p>Programi i studimit është strukturuar dhe përmirësuar bazuar në eksperiencën 10 vjeçare të ofrimit të këtij programi nga UNIEL si dhe mbështetur në modelet dhe praktikat më të mira të institucioneve partnere të arsimit të lartë.</p> <p>Struktura e programit, emërtimi, raporti teori-praktikë janë në përputhje me profilin e profesionit dhe me programet europiane. Projektet e mobilitetit (Erasmus+, Cost Action) si dhe projektet kombëtare të financuara nga AKKSHI në të cilat janë përfshirë staf akademik i Departamentit, studimet doktorale dhe bashkëpunimet me universitetet italiane etj. shërbejnë si një impuls i mirë për rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e vazhdueshëm strukturor të programit.</p> <p>Në takimet me zyrën e këshillimit të karrierës GVJ u informua se studentët e këtij programi studimi kanë mundur të transferojnë studime ose të ekuivalentojnë diplomën në vende të ndryshme europiane.</p> <p>(Evidencat 1.8/2.9 Rregullore dhe plani mësimor, Takimi me zyrën e këshillimit të karrierës dhe alumni)</p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Strukturimi i programit, unifikimi i termave të programit me programet europiane i bën studentët konkurrues në tregun e punës publik e privat, kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar. Ndarja në kategori sipas veprimtarive formuese dhe raportet e ngarkesës së tyre bazuar në legjisllacionin në fuqi, ngjashmëria e programit me programe në IAL të tjera, ndikon në arritjen e objektivave të programit dhe transferimin, mobilitetin e studentëve në programe të tjera studimi të ngjashme. Njohuritë e marra në këtë program dhe kurrikula e tij, ju krijon mundësi punësimi studentëve në sektorin publik dhe privat brënda dhe jashtë vëndit. Përditësimi i vazhdueshëm i programit me qëllim formimin profesional të infermierit, licensimin dhe punësimin në tregun e punës ka ndihmuar në njohjen e programit në vënde të BE dhe integrim në tregun europian. Në takimin me pedagogë dhe studentë u referua se të paktën një student i këtij programi dhe disa pedagogë kanë kryer mobilitet në programet Erasmus.</p> <p>(Evidencat 1.15 Komiza konceptuale e programit te studimit, 2.9 Plani mësimor)</p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>FSHMT dhe njësitë bazë kanë një praktikë të mirë dokumentuar lidhur me rishikimin në mënyrë të vazhdueshme të programit apo syllabuseve të lëndëve duke u bazuar në literaturë ndihmëse dhe të detyruar. Programi i studimit ju siguron studentëve literaturën bazë që janë tekste mësimorë të pedagogëve të UNIEL apo UMT, cikle leksione të shkruara të përgatitura nga pedagogët e lëndës. Tekset mësimorë për pjesën teorike, seminare, laboratore, ushtrime propozohen nga titullarët e lëndëve dhe miratohen nga departamenti. Ky informacion gjëndet në fund të çdo syllabusi. Formati i hartimit të tekseve mësimore është i miratuar me vendim të</p>

	senatit akademik. Në syllabuse është punuar për përditësimin e literaturës së huaj e ndihmuar dhe nga rikonceptimi i funksionimit të bibliotekës. <i>(Evidenca 2.12 Paketa e syllabuseve, Takimet në institucion)</i>			
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Përmbajtja e programit të studimit i shërben rritjes së kapaciteteve profesionale në fushën e shërbimit infermieror në obstetrikë-gjinekologji, aftësimin profesional teorik dhe praktik. Në takimin me drejtues të institucionit dhe të departamentit u referua se DSMT po punon për përditësimin e kurrikulës. <i>(Evidencat 2.9 Plani mësimor, 1.8 Rregullorja e programit të studimit, 1.7.1 Rregullore e DSTM)</i>			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përmbajtja e programit i shërben studentëve për fitimin e njohurive bazë në obstetrikë-gjinekologji dhe thellimin e njohurive të përfuara në këtë program studimi në kualifikime të mëtejshme apo ndjekje të doktoraturës. Lëndët/modulet që studenti zhvillon në këtë program studimi përbëjnë bazën për përfitim të kompetencës profesionale për punësimin e tyre dhe përshtatjen e tyre me kërkesat e tregut të punës. (Evidencat 1.3.1 Strategjia e zhvillimit të FSHMT, 1.8 Rregullorja e programit të studimit)			
Konkluzione	GVJ gjykon se Standardi II.4 përmbushet plotësisht. <i>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxëniet dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Programi i studimit Master i Shkencave në "Mami" synon përgatitjen e specialistëve të aftë për të përballuar sfidat e tregut lokal të punës si dhe krijon premisa për ekuivalentim të programit në tregun rajonal e më gjerë si dhe për kualifikim në programe të niveleve më të larta. Në program ka një harmonizim të mirë të lëndëve të formimit bazë e karakterizues me praktikën profesionale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë	Departamenti çdo fillim viti akademik bën përditësimin e programit të studimit dhe në mënyrë periodike angazhohet për përshtatjen e programit të studimit me kërkesat e tregut të punës. Në këtë proces një vend të rëndësishëm zënë dhe informacionet e marra gjatë takimeve me

<p>përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>përfaqësues nga institucione të tjera si IAL me profil mjekësor në vendin tonë, Urdhërin e Infermierit, apo dhe jashtë vëndit si DEKRA, EFN.</p> <p>Në takimet me drejtuesit e institucionit dhe personelin akademik GVJ u informua se përmes analizave dhe debatit shkencor në nivel Departamenti dhe Fakulteti diskutohen dhe aplikohen ndryshimet përmirësuese të programeve me kontributin e pedagogëve të përfshirë në mësimdhënie dhe profesorëve të ftuar. Mobiliteti dhe pjesmarrja në projekte ka bërë që stafi akademik të njihet dhe të aplikojë më mirë programe bashkëkohore që përshtasin programet aktuale me kërkesat e tregut të punës dhe me kërkesat e kartës së Bolonjës.</p> <p>Në dokumentacion nuk kemi gjetur një analizë të tregut të punës apo të dhëna për punësimin e studentëve. Në takimet me studentët dhe përfaqësuesit e zyrës së këshillimit të karrierës u informuam se studentët e programeve të studimit MSH në Infermieri apo Mami në përgjithësi punësohen në profesion ose zhvendosen për t'u punësuar jashtë Shqipërisë (kërkesa për suplementin e diplomës dhe programin).</p> <p><i>(Takimi me drejtues të FSHMT, Evidencat 1.12 Raporti i analizës vjetore të departamentit, 1.13 Marrëveshjet e bashkëpunimit)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Pjesë e rishikimit apo përditësimit të programit mësimor janë dhe propozimet e bëra nga studentët e programit të cilët janë në proces ose ata që kanë mbaruar ciklin e studimit. Mbështetja e studentëve dhe përfshirja e tyre në përmirësimin e programeve realizohet me anë të përfshirjes së studentëve në bordin e administrimit, këshilli studentor, senatin akademik. Duke qënë pjesë e vendimarrjes ata ndikojnë dhe në përmirësim të programit të studimit.</p> <p>Institucioni përdor mekanizma të ndryshme për marrjen e mendimit të studentëve për programin mësimor si plotësimi i përvitshëm pyetësorëve. Një anë positive është përfshirja në këto konsultime edhe e studentëve të punësuar në struktura shëndetësore.</p> <p>Institucioni ka një databazë për studentët që ndjekin studimet në programet e studimit si dhe për studentët e diplomuar prej të cilëve merr dhe informacion për kërkesat e tregut të punës dhe mundësitë në punësimin e studentëve.</p> <p><i>(Evidencat 1.12. Raporti i analizës vjetore të departamentit, 2.1 Lista e anëtarëve të Senatit akademik UNIEL, 2.2 Rregullore e Këshillit Studentor, 5.7 Të dhënat mbi punësimin e të diplomuarve, Takimi me studentët)</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra</p>	<p>Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me Urdhërin e Infermierëve të Shqipërisë, me institucione spitalore dhe të shërbimit primar, institucione homologe jashtë Shqipërisë. Rrjeti i gjerë i bashkëpunëtorëve kontribuon ndjeshëm në përmirësimin e përditësimin e programit të studimit.</p> <p>Çdo vit akademik njësia bazë ku zhvillohet ky program studimi bën rishikim dhe përditësim të kurrikulave. Një vënd të rëndësishëm në këtë proces zënë shkëmbimet e eksperiencave me programe të njëjta,</p>

(veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	organizimet e leksioneve të hapura me lektorë të ftuar nga fusha e biznesit apo urdhërat profesionale në fushën e shëndetit. <i>(Evidencat 1.13, 1.14 Marrëveshjet e Bashkëpunimit, Takimet në institucion)</i>			
Konkluzione	<i>GVJ gjykon se standardi II.5 përmbushet plotësisht. Institucioni ka krijuar kushte për përmirësim dhe përditësim të programeve të studimit në përputhje me kërkesat e kohës. Departamenti çdo fillim viti akademik bën përditësimin e programit të studimit për përshtatjen më të mirë të tij me kërkesat e tregut të punës. Institucioni përfshin në procesin e rishikimit të kurrikulave studentët me anë të mekanizmave të ndryshme si plotësimi i përvitshëm i pyetësorëve, përfshirjen e përfaqësuesve të tyre në senatin akademik, këshillin studentor. Një anë positive është përfshirja në këto konsultime edhe e studentëve të punësuar në struktura shëndetësore. Institucioni ka një databazë për studentët që ndjekin studimet në programet e studimit si dhe atyre që kanë përfunduar studimet prej të cilëve merr dhe informacion për kërkesat e tregut të punës dhe mundësitë në punësimin e studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	<p>Në dokumentin e strategjisë së FSHMT përcaktohen si objektiva madhorë dhe si mision:</p> <ul style="list-style-type: none"> • krijimin, zhvillimin, përcjelljen dhe mbrojtjen e dijeve përmes mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. • formimin e specialistëve të lartë të specialiteteve mjekësore të aftë profesionalisht në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit, për rritjen e standardeve dhe të cilësisë së shërbimit. • ofrimin e mundësive të barabarta për të përfutur nga arsimit i lartë dhe të mësuarit gjatë jetës. • kontributin në zhvillimin ekonomik, shëndetësor dhe social-kulturor kombëtar dhe rajonal • mbështetjen e prioritetëve strategjike dhe interesave të zhvillimit të vendit. • integrimin e mësimdhënies me kërkimin shkencor • nxitjen e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e arsimit të lartë të shkencave mjekësore. <p>FSHMT ka si qëllim ruajtjen dhe konsolidimin e programeve të studimit që ofron dhe pasurimin e kurrikulës universitare me programe të reja</p>

	<p>studimi. Programi i studimit MSH në "Mami" ka si objektiv kryesor formimin profesional dhe shkencor bashkëkohor të specialistit në fushën mami, orientimin e tyre drejt kërkimit shkencor dhe ofrimin studentëve të një diplome cilësore në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke u mbështetur në prioritet strategjike dhe zhvillimin ekonomik të vëndit.</p> <p>(Evidenca 1.3.1 Strategjia e FSHMT)</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Njësia kryesore dhe bazë ku zhvillohet ky program studimi organizon dhe administron aktivitetin e mësimdhënies, aktivitetet dhe veprimtaritë kërkimore shkencor duke respektuar opinionet, idetë dhe metodat në garantimin e zhvillimit të lirë, kritik dhe krijues të procesit të mësimdhënies, aktivitetit kërkimor shkencor dhe veprimtarive të tjera akademike. Institucioni organizon dhe leksione të hapura me personalitete nga fusha të ndryshme përfshirë dhe mjekësinë të cilët bashkëbisedojnë më pedagogët dhe studentët për problematika të veçanta lidhur me profesionin. Prej vitesh FSHMT bashkëpunon me Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Barit dhe Universitetin e Aquila, Itali; pedagogë të këtyre universiteteve vijnë dhe zhvillojnë tema të ndryshme me studentët e programeve Master.</p> <p>(Evidenca 1.12.1 Analiza vjetore e departamentit 2020-2021)</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Programi i studimit i motivon studentët të përfshihen në punë të mirëfilltë projektuese dhe kërkimore që kontribuojnë në formimin profesional dhe shkencor. Studentët janë angazhuar në organizimin dhe pjesëmarrjen e tyre në seminare, workshope, konferenca shkencore apo trainuese. Studentët janë pjesëmarrës në këto aktivitete me punimet e tyre si tema kursi, diplome, projekte apo aktivitete të tjera kërkimore. Pedagogët dhe udhëheqësit shkencorë i mbështesin studentët për publikimin e këtyre në Buletin shkencor të fakultetit apo revista të tjera. Të dhënat e aktivizimit të studentëve në aktivitetin shkencor të Departamentit të Specialiteteve Tekniko-Mjekësore janë pasqyruar në tabelën 22 të RVB.</p> <p>(Evidencat 2.5 Të dhëna mbi aktivitetet 2021-2022, 2.6 Të dhënat mbi revistën periodike Buletini UNIEL)</p>
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.</p>	<p>Në takimin me stafin akademik u referua se institucioni i mbështet financiarisht në realizimin e aktiviteteve kërkimore shkencore duke i përfshirë në projekte të ndryshme si psh dy projekte me AKSHIN. Në tabelën e buxhetit për vitet 2019, 2020, 2021, në zërat e të ardhurave janë përfshirë edhe grantet për kërkim, projektet e huaja dhe sponsorizimet.</p> <p>(Evidencat 2.3 Miratimi i Buxhetit, 2.6 Të dhënat mbi revistën periodike Buletini UNIEL)</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ gjykon se standardi II.6 përmbushet plotësisht.</p> <p><i>Njësia kryesore/bazë ku zhvillohet ky program studimi organizon dhe administron aktivitetin e mësimdhënies, aktivitetet dhe veprimtaritë kërkimore shkencore. Institucioni organizon dhe leksione të hapura me personalitete nga fusha të ndryshme përfshirë dhe mjekësinë të cilët bashkëbisedojnë më pedagogët dhe studentët për problematika të veçanta</i></p>

	<i>lidhur me profesionin. Institucioni mbështet finaciarisht stafin akademik në aktivitetin kërkimor shkencor duke i përfshirë në projekte shkencore. Program i studimit i motivon studentët duke i përfshihen në punë të mirëfillta projektuese dhe kërkimore që kontribuojnë në formimin profesional dhe shkencor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	<p>UNIEL i kushton një rëndësi të veçantë harmonizimit të aktivitetit mësimor me atë kërkimor shkencor ku një vëmendje e veçantë i kushtohet përfshirjes së studentëve në kërkim shkencor. Institucioni ka investuar për ndërtimin e ambienteve të paisur me teknologji të përparuar, ka aplikuar dhe fituar projekte të finacuara nga institucione kombëtare apo ndërkombëtare. FSHMT për realizimin e punëve kërkimore shkencore ka marrëveshje bashkëpunimi me strukturat spitalore rajonale. Në takimet me drejtuesit e FSHMT dhe stafin akademik u informuam për inkurajimin dhe mbështetjen që jep kjo njësi për përfshirjen e stafit në programet ndërkombëtare të mobilitetit apo për përfshirjen në projekte kërkimore të përbashkëta si partnerë.</p> <p><i>(Evidencat 1.13 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit, 1.3.1 Strategjia e FSHMT, 3.1 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit Erasmus)</i></p>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	<p>Për realizimin e objektivave të kërkimit shkencor institucioni ka njësinë e kërkimit shkencor dhe projekteve e cila informon stafit për thirrjet e projekteve me fonde nga burime jashtë institucionit. Kjo njësi asiston stafin në shkrimin dhe përgatitjen e projekteve dhe pas miratimit monitoron zbatimin dhe realizimin e tyre. Pjesë e këtyre projekteve janë dhe studentët të tre cikleve të studimit.</p> <p><i>(Takimi me njësinë e kërkimit shkencor dhe projekteve dhe stafin akademik)</i></p>
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	<p>Pjesë e rëndësishme e aktivitetit mësimor dhe kërkimor shkencor është organizimi i aktiviteteve trainuese, seminareve dhe konferencave nga njësia kryesore në fusha dhe probleme të veçanta të mjekësisë. Një vënd të rëndësishëm zënë dhe ditët e hapura, leksionet e hapura me pedagogë të ftuar, ku studentët janë pjesëmarrës aktivë në këto aktivitete nëpërmjet paraqitjes së temave të studimit, rezultateve të projekteve ku kanë qënë pjesëmarrës me pedagogët e tyre apo botime në revista shkencore të universitetit.</p>

	<i>(Evidenca 1.3.1 Strategjia e FSHMT)</i>			
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Programi studimit bazuar në objektivat dhe misionin e tij synon rritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e infermieristikës në obstetrikë-gjinekologji dhe përgatitjen e specialistëve të aftë për ofrimin e shërbimit shëndetësor cilësor në këtë fushë. Programi e arrin këtë nëpërmjet aftësimin dhe kompetencës profesionale, zhvillimit të aftësive të komunikimit midis stafit mjekësor, pacientëve dhe familjarëve të tyre të nevojshme për t'u përshtatur me tregun e punës brënda vëndit apo jashtë tij. <i>(Evidenca 2.9 Plani mësimor)</i>			
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesioniste, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	Kriteri nuk aplikohet në këtë program studimi			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (<i>p.sh. Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Referuar nenit 5 të Ligjit 10171 datë 22.10.2009 “Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë”, profesioni i mamisë hyn në profesionet e rregulluara. Megjithatë, programi i studimit MSH në “Mami” është program kualifikimi që ofrohet për studentë që kanë përfunduar ciklin e studimeve Bachelor në Mami pas të cilit liçensohen në profesion. Programi Bachelor në të njëjtën fushë i ofruar nga UNIEL përputhet me aktet ligjore kombëtare dhe të BE për profesionet e rregulluara. Ai ofron studim trevjeçar teoriko-praktik siç kërkohet në nenin 40 të <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i> . Kurrikula e programit në një pjesë të madhe ka përafërsi me rekomandimet e aneksit 5.5.1 të të njëjtës direktivë.			
Konkluzione	<i>GVJ gjykon se standardi II.7 përmbushet plotësisht.</i> <i>UNIEL harmonizon aktivitetin mësimor me atë kërkimor shkencor dhe ka në fokus përfshirjen e studentëve në kërkim shkencor. Institucioni ka investuar për ndërtimin e ambienteve të paisur me teknologji të lartë dhe mbështet aplikimet dhe fitimin e projekteve të financuar nga institucione kombëtare apo ndërkombëtare. FSHMT për realizmin e punëve kërkimore shkencore ka marëveshje bashkëpunimi me strukturat spitalore rajonale. Programi studimit ka krijuar infrastrukturën e nevojshme për rritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e mamisë, zhvillimin e aftësive të komunikimit të nevojshme për tu përshtatur me tregun e punës brënda vëndit apo jashtë tij.</i> <i>Institucioni ka njësinë e kërkimit shkencor dhe projekteve e cila informon stafit për thirrjet e projekteve me fonde nga burime jashtë institucionit.</i>			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1																																	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.																																	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																																
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Për zhvillimin e procesit mësimor institucioni/programi i studimit ka parashikuar përdorimin e metodave të ndryshme në transmetimin e dijeve si leksione, seminare, laboratorë, praktika profesionale e klinike, përgatitjen e detyrave të kursit, tema diplome, punë kërkimore në laborator, si dhe leksione të hapura të organizuara nga departamenti. Institucioni inkurajon gjithashtu pjesmarrjen e studentëve në konferenca, trajnime dhe workshop. Aktivitetet trajnuese klinike janë pjesë integrale e programeve të lëndëve infermieristike (p.sh. infermieristikë e gjinekologjisë, infermieristikë barra e lindja normale etj.). Departamenti aplikon dhe aktivitete trajnuese të zgjeruara në formën e workshopeve.</p> <p>Departamenti i Specialiteteve Tekniko-Mjekësore inkurajon përfshirjen e studentëve të programeve Master Shkencor në punimet shkencore të pedagogëve apo në projekte shkencore në rang Departamenti e Fakulteti (<i>tabela 22 e RVB</i>).</p> <p>Në organizimin e studimeve një vend të rëndësishëm ze dhe puna e pavarur e studentit (rreth 60% e orëve totale).</p> <p>Tabela e mëposhtme paraqet informacion më të detajuar të përmbledhur nga tabela e planit mësimor në RVB. Diploma në total ka 450 orë prej të cilave 30 janë orë në auditor.</p> <table border="1"> <thead> <tr> <th>MSH në "Mami"</th> <th>Viti I</th> <th>Viti II</th> <th>Në total</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Orë në auditor</td> <td></td> <td></td> <td>1142 (38%)</td> </tr> <tr> <td>- Leksione</td> <td>384</td> <td>252</td> <td>636</td> </tr> <tr> <td>- Seminare</td> <td>96</td> <td>60</td> <td>156</td> </tr> <tr> <td>- Praktika profesionale</td> <td>160</td> <td>160</td> <td>320</td> </tr> <tr> <td>- Përgatitje e mikrotezës</td> <td></td> <td>30</td> <td>30</td> </tr> <tr> <td>Punë e pavarur e studentit</td> <td></td> <td></td> <td>1858 (62%)</td> </tr> <tr> <td>Gjithsej</td> <td></td> <td></td> <td>3000</td> </tr> </tbody> </table>	MSH në "Mami"	Viti I	Viti II	Në total	Orë në auditor			1142 (38%)	- Leksione	384	252	636	- Seminare	96	60	156	- Praktika profesionale	160	160	320	- Përgatitje e mikrotezës		30	30	Punë e pavarur e studentit			1858 (62%)	Gjithsej			3000
MSH në "Mami"	Viti I	Viti II	Në total																														
Orë në auditor			1142 (38%)																														
- Leksione	384	252	636																														
- Seminare	96	60	156																														
- Praktika profesionale	160	160	320																														
- Përgatitje e mikrotezës		30	30																														
Punë e pavarur e studentit			1858 (62%)																														
Gjithsej			3000																														

<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p><i>(Evidencat 2.9/2.12 Plani Mësimor dhe Syllabuset, Tabelat e RVB)</i></p> <p>Në takimet në institucion me personelin akademik dhe me studentët GVJ u informua se personeli akademik ka përvojë dhe ofron për studentët mënyra e metoda alternative të mësimdhënies dhe mësimnxënies në përputhje me nevojat e tyre. Gjatë mësimdhënies përdoren metoda të tilla si prezantime në ppt., video, biseda interaktive me studentët, demonstrimi i procedurave praktike laboratorike me mulazhe, ushtrime me raste klinike etj. Staf i akademik asiston apo ndihmon studentët për zgjidhjen e problemeve të ndryshme që dalin gjatë zhvillimit të mësimi teorik, laboratorëve mësimore apo praktikave profesionale ku synohet pjesmarrje aktive në procedura praktike infermiere. Në takimin me stafin akademik GVJ konstatoi se pedagogu ka liri akademike në zhvillimin e orës së leksionit; stimulohet mësimi interaktiv që kombinon shpjegimin me pyetjet për subjektin e shpjeguar apo ushtrimet në lidhje me të.</p> <p>Periudha e pandemisë ishte një sfidë për mësimdhënien por që rezultoi e realizuar me sukses. Personeli IT i institucionit realizoi trajnime dhe përgatiti dokumenta trajnues për aftësimin e personelit akademik në mësimdhënien online.</p> <p><i>(Takimet dhe vizitat në institucion, Evidencat 1.3.1 Strategjia e FSHMT, 1.12.1 Raporti vjetor i Departamentit, 6.1 Guida e pedagogut për mësimin on line)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të nxënësve.</p>	<p>Institucioni ka siguruar infrastrukturën mësimore e cila bën të mundur përdorimin e metodave pedagogjike fleksible të përshtatshme me temat e lëndëve dhe objektivat e pritshme të tyre në funksion të formimit profesional teorik të studentëve. Në funksion të procesit mësimor dhe aktivitetit kërkimor janë laboratorët e anatomi-histologjisë, biokimik-klinik, infermieristik (i paisur me mulazhe), si dhe laborator i informatikës. Në laboratorin e anatomi-histologjisë institucioni ka realizuar një investim vizionar që përmirëson mjaft mësimdhënien dhe mësimnxënien interaktive në këto lëndë mjaft të rëndësishme të formimit të përgjithshëm mjekësor. Institucioni mbështet pedagogët për përmirësimin e aftësive dhe kompetencave profesionale dhe metodave të mësimdhënies, nëpërmjet mbështetjes për pjesmarrje në konferenca shkencore, aktivitete trainuese, përgatitje të projekteve, përfshirjen e tyre në marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike apo jo publike.</p> <p><i>(Evidencat 3.1/3.2 që kanë të dhënat për mobilitetet, tabelat 16/19/20 të RVB, vizita dhe takimet në institucion)</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi në përgjithësi ka përgatitje profesionale, ekspertizën e duhur dhe eksperiencë mjekësore apo pedagogjike në lëndët që zhvillon.</p>

ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit si CV e stafit akademik, Planit mësimor, Tabelat 4, 6.1, 6.2 të RVB, GVJ konstatohet se:

- *formimi profesional jo gjithmonë përputhet me lëndën që zhvillon në këtë program studimi. P.sh. mjek i sapodiplomuar Msc në Mjekësi të përgjithshme jep lëndë specialistike si gjinekologji invazive, pedagogë të diplomuar në infermieri të përgjithshme apo menaxhim infermioror japin lëndë të profileve specifike në obstetrikë-gjinekologji.*
- *Ka pedagogë që japin më shumë se tre lëndë dhe ngarkesa mësimore e tyre është mbi normën e parashikuar nga legjislacionit në fuqi.*
- *Ka pedagoge lektorë të kategorisë Msc, kur legjislacioni përcakton që lektorët duhet të zotërojnë gradën "Doktorë Shkence".*

Me vendimin e senatit akademik Nr.24 datë 12.04.2020, UNIEL ka përcaktuar procedurat dhe kriteret për punësim të personelit akademik. Kriteret janë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Në takimet me drejtuesit e institucionit u informuam që megjithatë institucioni has vështirësi për rekrutimin e stafit me kualifikim të lartë të kategorive Dr dhe Prof. Institucioni punon për promovimin e personelit akademik dhe inkurajimin e përfshirjes së tij në shkollën e doktoraturës.

Sipas tabelës 2 të RVB personeli akademik i njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit për dy vite akademike paraqitet si më poshtë:

Tituj/ grada	2021-2022		2020-2021	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	0	0	0	0
Prof.Asc.	2	0	2	0
Dr./PhD.	1+1*	3	1+1*	2
Msc.	3	16	3	22
Totali	7	19	7	24
* Doktoraturë në proçes				

Lidhur me treguesit e moshës konstatohet se lektorët e kategorisë Profesor Asc. dhe me gradën Doktor i përkasin grupmoshës 36 – 55 vjeç. Në tabelat e ngarkesës mësimore të programit rezulton se mbi 80% e ngarkesës përballohet nga PAE.

Institucioni ka të siguruar logjistikën e nevojshme për zhvillimin e proçesit mësimor, praktikave, aktivitetin kërkimor të studentëve etj. Personeli akademik është aftësuar dhe ka realizuar me sukses dhe metodat e punës on line sipas tematikave dhe profilit.

Në takimin me studentët konstatuam se ata janë të kënaqur me cilësinë e mësimdhënies, me komunikimin dhe ndërveprimin e pedagogëve në

	<p>orët e mësimit si dhe me materialet didaktike që pedagogët pregatisin për procesin mësimor. Studentët ndihen të mbështetur dhe konstatohet një frymë pozitive hierarkie dhe bashkëpunimi.</p> <p><i>(Tabelat e RVB, takimet dhe vizita në institucion)</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Institucioni vlerëson në mënyrë periodike stafin akademik, procesin e mësimdhënies duke përfshirë në këtë proces edhe studentët nëpërmjet plotësimit të pyetësori të vlerësimit, takimet e studentëve me koordinatoren e programit. Rezultatet e raportuara nga NJSBC në raportin vjetor tregojnë se studentët e gjykojnë tërheqës procesin mësimor dhe sfidues detyrat e pedagogëve. Rezultatet e pyetsorëve përdoren nga njësia kryesore për hartimin e politikave të përmirësimit. Në takimin me studentët ata u shprehën se shpjegimi është i qartë dhe reflekton përdorimin e metodave inovative. Në orën e mësimit ka bashkëveprim interaktiv pedagog-student. Institucioni mbështet dhe inkurajon bashkëpunimin dhe respektin e ndërsjelltë pedagog-student që reflektohet dhe në realizimin e konferencave studentore.</p> <p><i>(Takimet dhe vizita në institucion, Evidenca 6.2 Raport mbi rezultatet e pyetësorit studentor për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies)</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>Institucioni ka riorganizuar NJSBC e cila koordinon dhe bashkëvepron me njësitë kryesore/bazë për përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie. Institucioni përmes strukturave organizative të tij mbështet trajnimin dhe pjesmarrjen e stafit akademik në projekte zhvillimi në të cilat veç aftësimin shkencor fitohet dhe eksperiencë në mësimdhënie. Për promovimin e aktivitetit shkencor të pedagogëve institucioni pregatit dhe boton në mënyrë periodike BULETININ e UNIEL, organizon aktivitete e konferenca me bashkëpunimin e partnerëve kombëtarë e ndërkombëtarë.</p> <p>Personeli është trajnuar dhe mbështetet vazhdimisht për aplikimin e metodave të reja të mësimdhënies on line.</p> <p>Institucioni vlerëson arritjet e stafit akademik dhe i prezanton në analizat e departamentit dhe fakultetit. NJSBC e sapororganizuar ka krijuar protokollat për përgatitjen e pyetsorëve në nivel institucional. Pedagogu plotëson dhe dorëzon çdo vit, skedën vetjake të vetëvlerësimit ku shprehet dhe dokumenton arritjet në veprimtaritë shkencore.</p> <p>Në takimet me stafin akademik u konstatua fryma pozitive e institucionit në raport me bashkëveprimin hierarkik dhe horizontal në nivel njësie qëndrore dhe njësie bazë.</p> <p><i>(Evidencat 6.8 Rregullore e NJSBC, 2.6 të dhëna mbi revistën, takimet dhe vizita në institucion)</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ gjykon se standardi III.1 përmbushet kryesisht. Institucioni garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve. Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka përgatitje profesionale dhe eksperiencë</i></p>

	<p><i>mjekësore apo pedagogjike në lëndët që zhvillon. Megjithatë, GVJ konstatoi se formimi profesional jo gjithmonë përputhet me lëndën që pedagogu zhvillon në këtë program studimi Ka Lektorë pedagoge të kategorisë Msc, ku legjislacioni përcakton që lektorët duhet të jenë të zotërojnë gradën "Doktorë Shkence".</i></p> <p><i>Institucioni ka siguruar infrastrukturën mësimore e cila bën të mundur përdorimin e metodave pedagogjike fleksible të përshtatshme me temat e lëndëve dhe objektivat e pritshme të tyre në funksion të formimit profesional teorik të studentëve. Institucioni mbështet dhe promovon aktivitetin shkencor të stafit akademik.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.2	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Institucioni zotëron gjithë bazën e nevojshme ligjore që rregullon organizimin e provimeve dhe vlerësimi e njohurive të studentëve të cilat bëhen publike dhe njihen nga studentët që në fillim të vitit akademik dhe u vihet këtyre të fundit në dispozicion. Në rregulloren e programit të studimit dhe në rregulloret e përgjithshme të institucionit përcaktohen në mënyrë specifike të gjitha rregullat dhe modalitetet e testimit të njohurive. Në syllabuset e lëndëve pasqyrohen format e kontrollit të njohurive.</p> <p>UNIEL prej disa vitesh përdor dhe systemin e automatizuar për korrigjimin e provimeve CLEANSCORE të financuar nga AADF.</p> <p>(Evidencat 1.1 Statuti i UNIEL, 1.4 Rregullore e UNIEL, 1.7 Rregullore e FSHMT, 1.8 Rregullore e Programit të studimit, 2.7 Rregullore e Departamentit të SMT)</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Studentët informohen në fillim të vitit akademik nga titullari i lëndës/modulit mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore. Metodologjia e vlerësimit përshkruhet dhe në syllabuset e lëndëve/moduleve dhe rregulloret e funksionimit të Fakultetit, dhe programit të studimit. Vlerësimi bëhet në mënyrë të vazhdueshme. Të dhënat për mënyrën e vlerësimit janë pasqyruar në tabelën 15 të RVB dhe në syllabuse.</p> <p>Pedagodu informon studentit për mënyrën e frekuentimit të procesit mësimor dhe vlerësimit të dijeve. Frekuentimi i procesit mësimor teorik (leksione, seminare) është i detyrueshëm në masën 80% të orëve, frekuentimi laboratorëve mësimore dhe praktikës profesionale në masën 100%.</p>

	<p>Në rregulloren e Departamentit të Specialiteteve Tekniko-Mjekësore dhe në Rregulloren e programit të studimit përcaktohen qartë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Format e kontrollit të dijeve • Sistemi i vlerësimit për lëndë e module • Sezonet e provimeve • Kushtet për të hyrë në provim • Mënyra e zhvillimit të provimeve • Mënyra e vlerësimit dhe kushtet kur studenti konsiderohet i kalues/i mbetur • Dokumentimi i rezultateve • Proçedurat e ankimimit, riprovimeve, përmirësimit <p><i>(Evidenca 1.8 Rregullorja e programit të studimit, rregullorja e diplomimit, Takimi me studentët)</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme. Elemente kryesore të kontrollit të vazhdueshëm janë: provimet, detyrat e kursit dhe niveli i aktivizimit në seminare/laboratore, provimi diplomimit. Vlerësimi i vazhdueshëm i jep mundësi studentit të demonstrojë më mirë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p> <p>Në takimin me stafin akademik u informuam se provimi zhvillohet me shkrim me gojë ose i kombinuar. Tezat e provimit hartohen nga titullari i lëndës/modulit dhe firmoset nga drejtuesi i njësisë bazë para zhvillimit të provimit. Kohëzgjatja e provimit përcaktohet në rregulloren e programeve të studimit nga njësia bazë. Korrigjimi i provimit me shkrim bëhet nga komisioni i provimit dhe rezultatet u bëhen të njohura studentëve brënda 6 ditëve pas zhvillimit të provimit. Komisioni cakton një ditë për dhënien e rezultateve studentëve apo shqyrtimin e ankesave për vlerësimin e kryer. Provimi i praktikës zhvillohet me gojë. Merret vlerësimi nga mbikqyrësi i praktikës në spital dhe më tej student pyetet me gojë për të marrë vlerësimin përfundimtar.</p> <p>Për të vlerësuar njohuritë e studentit përdoret sistemi i vlerësimit me 10 nota, nga 1-shi tek 10-ta, ku 10-ta është vlerësimi maksimal. Nota më e ulët për kalim në një lëndë është 5 (pesë).</p> <p>Proçedura e provimeve kryhet në bazë të rregullores së programit të studimit/rregullorja e departamentit. Njoftime të detajuara për lëndët dhe provimet vendosen dhe në platformen EMS si edhe njoftohen direkt nga departamenti.</p> <p><i>(Rregullore e programit të studimit, paketa e syllabuseve, RVB, takimi me stafin)</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ gjykon që Standardi III.2 përmbushet plotësisht. Institucioni zotëron gjithë bazën e nevojshme ligjore që rregullon organizimin e provimeve dhe vlerësimi e njohurive të studentëve të cilat bëhen publike dhe njihen nga studentët që në fillim të vitit akademik dhe u vihet këtyre të fundit në dispozicion. Studentët informohen në fillim të vitit akademik nga titullari i lëndës/modulit mbi metodologjinë e</i></p>

	<p>testimit dhe vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore. Informacioni i detajuar gjendet në rregulloren e programit të studimit. Vlerësimi i studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme. që realizohet me anë të provime, detyrat e kursit dhe niveli i aktivizimit në seminare, praktika, provimi diplomimit. Provimi zhvillohet me shkrim me gojë ose i kombinuar. Njoftime te detajuara për lëndët dhe provimet vendosen dhe në platformen EMS si edhe njoftohen direkt nga departamenti.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3	
Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Në rregulloren e programit të studimit, në tabelat e RVB dhe syllabuse përcaktohet se:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 10 % e pikëve të notës fitohen nga ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja aktive • 10 % e pikëve të notës fitohen nga testimet e kryer gjatë vitit • 80 % e pikëve të notës fitohen nga provimi përfundimtar <p>Vlerësimi i studentit me pikë shënohet në fletën e provimit, dhe në bazë të rregullores së departamentit numri i pikëve i referohet notës përkatëse. Mënyra e vlerësimit është e parashikuar në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari lëndës/pedagogu.</p> <p>Nota e parë kaluese është 5(pesë) që merret kur studentit siguron të paktë 45% të pikëve (45/100). Vlerësimi maksimal është 10 (dhjetë) për të cilin studentit duhet të grumbullojë 95 – 100 pikë.</p> <p>Diplomimi realizohet pas mbrojtjes së një mikroteze. Protokollit i mikrotezës dhe mënyra e vlerësimit përcaktohen në rregulloren e departamentit dhe të programit të studimit.</p> <p><i>(Evidencat 1.8 Rregullore e Programit të studimit, 2.7 Rregullore e Departamentit të STM, syllabuset)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Në UNIEL zbatohet prej disa vitesh sistemi i automatizuar i korigjimit të provimeve në disa programe studimi, në sajë të projektit CLEANSORE të financuar nga AADF. Metoda e përdorur për provim është testimi me shkrim me sekretim të të dhënave të studentit nga përfaqësuesit e sekretarisë mësimore, me qëllim ruajtjen e anonimitit të studentit. Pasqyrimi i vlerësimit të studentit kryhet nëpërmjet sistemit EMS.</p>

	<i>(Evidenca 1.8 Rregullorja e programit të studimit, 2.7 Rregullore e Departamentit të STM, 3.4 Marrëveshja për implementimin e CLEANSORE)</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	<p>Testimi përfundimtar i lëndës realizohet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Provimi realizohet me shkrim, me gojë ose i kombinuar nga një komisioni i përbërë nga tre pedagogë. Ndërsa provimi me shkrim realizohet me praninë e së paku të dy pedagogëve në varësi të numrit të studentëve dhe sallës në dispozicion. Teza e provimit hartohet nga pedagogu që ka zhvilluar leksionet, kontrollohet nga titullari lëndës dhe miratohet nga përgjegjësi i departamentit. Sekretaria mësimore nxjerr frekuentimin e leksioneve, seminareve dhe praktikave të studentit si dhe konfirmon realizimin e pagesave që ka detyrim studentit përpara se ai të hyjë në provim. Proçesverbali i provimit gjenerohet nga sistemi dhe firmoset nga pedagogaogët që kanë realizuar provimin. Mbarëvajtja e provimit është përgjegjësi e sekretarisë/kordinatorit dhe komisionit të provimit. GVJ u njoh në sekretarinë mësimore me formatin e fletës së provimit dhe proçedurën.</p> <p><i>(Evidencat 2.7 Rregullorja e departamentit të SMT, 1.8 Rregullorja e programit të studimit, 4.11 Rregullorja e EMS, takimi me sekretarinë mësimore)</i></p>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi proçesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	<p>Studenti hyn në provim pasi ka kryer detyrimet e proçesit mësimor për çdo lëndë dhe detyrimet financiare sipas kontratës që ka me institucionin. Në rregullore përcaktohen qartë detyrimet që lidhen jo vetëm me ndjekjen e proçesit mësimor por dhe me numrin e ECTSve teoriko-praktike dhe llojin e lëndëve që studentit duhet të ketë të plotësuar para futjes në një sezon provimi.</p> <p>Kur provimi kryhet me gojë vlerësimi shoqërohet me komente dhe këshillime të studentit për performancën e arritur në provim. Ndërsa në provimet me shkrim komentet dhe sygjërimet kryhen në seancën e komunikimit të rezultateve. Në këto seanca pedagogu i mundëson studentit, nëse dëshiron, të shikojë rezultatet e provimit.</p> <p><i>(Evidencat 2.7 Rregullorja e departamentit të SMT, 1.8 Rregullorja e programit të studimit, syllabuset)</i></p>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	<p>UNIEL ka krijuar mekanizma për të luftuar plagjiaturën dhe kopjimin në provime. Në institucion funksionon Kodi i Etikës që plagjiaturën e konsideron sjellje të ndaluar. Në rregulloret e institucionit dhe në kodin e etikës pasqyrohen penalitete për rastet e kopjimit apo plagjiaturës. Sekretaria është përgjegjëse për sekretimin e fletëve të provimit ndërsa komisioni i vlerësimit është përgjegjës për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e provimit. Gjatë zhvillimit të provimit nuk lejohet përdorimi i telefonave celularë apo komunikimi midis studentëve. Me rregulloren e zhvillimit të provimit studentët njihen paraprakisht nga pedagogu i lëndës. Nëse konstatohet kopjim në provim apo detyra kursi studentit i jepet vërejtje dhe i zerohet rezultati i provimit.</p>

	<i>((Evidencat 1.4 Rregullore e UNIEL, 1.7 Rregullore e FSHMT, 2.7 Rregullore e Departamentit, 6.5 Kodi i Etikës))</i>
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Korrigjimi i provimit me shkrim bëhet nga komisioni i provimit dhe rezultatet u bëhen të njohura studentëve brënda 6 ditëve pas zhvillimit të provimit. Komisioni cakton një ditë për dhënien e rezultateve studentëve apo shqyrtimin e ankesave për vlerësimin e kryer. Studentët shprehen të kënaqur me procedurën e vlerësimit dhe deklaruan se vlerësimi është real dhe në përputhje me rregulloren e provimeve. Studentët njihen me rezultatin e provimeve në mënyrë konfidenciale përmes llogarisë së tyre personale në sistemin EMS. Nëse provimi realizohet me gojë rezultati merret menjëherë pas provimit. <i>(Evidencat 1.7 Rregullore e FSHMT, 1.8 Rregullore e Programit të Studimit, Takimi me studentët)</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Studentët kanë të drejtën e ankimit të rezultatit nëse kanë pakënaqësi apo paqartësi të lidhura me vlerësimin. Kjo e drejtë sanksionohet në rregulloret e institucionit dhe të programit të studimit. Këto rregullore i japin të drejtë studentit të njihet me vlerësimin, të ankimohet për vlerësimin, të mund të përmirësojë notën përmes riprovimit. <i>(Evidencat 1.7 Rregullore e FSHMT, 1.8 Rregullore e Programit të Studimit, Takimi me studentët)</i>
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Nëse studenti nuk është dakord me rezultatin e provimit dhe sqarimin nga pedagogu, i paraqet ankesë me shkrim drejtuesit të departamentit i cili bën verifikimet e duhura dhe nëse nuk e zgjidh ankesën vë në dijeni dekanin. Dekani ngre komision "ad hoc" për verifikimim e ankesës së studentit dhe bën verësimin e provimit. Nëse provimi është zhvilluar me gojë studenti përsërit provimin në prani të komisionit "ad hoc" duke tërhequr një tezë të dytë. Vlerësimi në këtë provim mbetet vlerësimi përfundimtar i studentit. Proçesi i ankimit kryhet në përputhje me rregulloren e provimit dhe rregulloren e programit të studimit. Ndryshimi i rezultatit të provimit pasqyrohet në proçesverbali e firmosur nga komisioni "ad hoc" dhe i bashkangjitet vlerësimit të komisionit të mëparshëm dhe sistemin EMS. E gjithë proçedura e ankesës dhe rivlerësimi të studentit dokumentohet dhe arkivohet në institucion pranë Sekretarisë Mësimore. <i>(Evidencat 1.7 Rregullore e FSHMT, 1.8 Rregullore e Programit të Studimit, Takimi me stafin akademik)</i>
Konkluzione	<i>GVJ gjykon se standardi III.3 përmbushet plotësisht.</i> <i>Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe proçesin e ankimit. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Mënyra e vlerësimit është e parashikuar në syllabuset e lëndëve/moduleve. Testimi përfundimtar i lëndës realizohet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Provimi realizohet me shkrim, me gojë ose i kombinuar. Mbarëvajtja e provimit është</i>

	<p>përgjegjësi e sekretarisë/kordinatorit dhe komisionit të provimit. Studentët njihen me rezultatin e provimeve në mënyrë konfidenciale përmes llogarisë së tyre personale në sistemin EMS. Studentët kanë të drejtën e ankimit të rezultatit nëse kanë pakënaqësi apo paqartësi të lidhura me vlerësimin. Kjo e drejtë sanksionohet në rregulloret e institucionit dhe të programit të studimit. Vlerësimi bazohet në meritë. UNIEL ka krijuar mekanizma për të luftuar plagjiaturën dhe kopjimin në provime.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4	
Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>Programi i studimit të ciklit të dytë MSH në “Mami” organizohet në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe mundëson formimin e thelluar profesional dhe zhvillimin e aftësive të veçanta si aftësi organizative, kërkim të pavarur shkencor, punën në grup etj.</p> <p>Programi ka kohëzgjatje 2 vite akademike dhe 120 ECTS. Një vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor të ndarë në dy semestra. Një semestër ka 15 javë mësimore në auditor. 1 orë mësimore – 50 minuta. 1 ECTS = 25 orë punë studenti në auditor dhe punë e pavarur jashtë auditorit; puna e pavarur zë mbi 50% të orëve për 1 ECTS (standardi II.1, kriteri 1) . Proçesi mësimor realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike si leksione seminare, praktika laboratorike, detyra kursi, apo prezantime apo praktika profesionale.</p> <p><i>(Evidencat 1.8 rregullorja e programit të studimit, 1.7 Rregullorja e FSHMT, 2.9 Plani mësimor)</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Programi mësimor krahas lëndëve të formimit bazë në fushën e infermieristikës në obstetrikë gjinekologji përmban dhe lëndë të formimit të përgjithshëm si gjuha e huaj, biostatistika, metoda të kërkimit shkencor, menaxhim shëndetësor. Përmes këtyre lëndëve synohet zhvillimi i aftësive në fushën e teknologjisë së informacionit, në fushën e komunikimit dhe ndërveprimit për menaxhim të pavarur të aktiviteteve profesionale dhe kërkimit shkencor në të ardhmen. FSHMT ka një laborator të kompletuar të informatikës në funksion të përgatitjes së studentëve.</p> <p><i>(Evidencat 2.9 Plani mësimor i programit të studimit, 2.12 Syllabuset vizita e ambienteve në institucion)</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në</p>	<p>MSH në “Mami” synon të pajisë studentët me njohuri të thelluara në profilin përkatës dhe të formojë profesionistë me</p>

<p>programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmblylëse.</p>	<p>kompetencën e nevojshme teorike dhe praktike për realizimin e misionit të infermierit specialist në fusha të specializuara të mjeksësisë, specifikisht në obstetrikë-gjinekologji. Gjithashtu një element i rëndësishëm i programit është pajisja e tyre me njohuri në fusha të veçanta të komunikimit dhe kërkimit për të cilën zhvillohet dhe një lëndë e veçantë në kurikulën e programit.</p> <p>Në përfundim të lëndëve, në orën e fundit të mësimit pedagogu bën një përmbledhje të tematikave të trajtuara duke u ndaluar në temat më të rëndësishme, si dhe orienton studentët ku duhet të fokusohen gjatë përgatitjes së tyre për provimin. Pedagogu ndalet në veçanti në temat që janë më të vështira për studentin gjatë zhvillimit të lëndës. Pedagogët i asistojnë studentët me konsultime me kërkesë të tyre. Në fund të praktikës profesionale pedagogu analizon dhe vlerëson aftësitë profesionale të fituara nga studentët.</p> <p><i>(Takimi me studentët dhe stafin akademik)</i></p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Në programin MSH në "Mami" janë angazhuar pedagogë me kualifikim dhe përvojë në mësimdhënie. Programi i studimit ndihmon përgatitjen e studentëve me njohuri, aftësi e kompetenca të nevojshme profesionale teorike dhe praktike për realizimin e misionit dhe për t'u përballur me kërkesat e tregut të punës. Gjatë vitit akademik, në përputhje me kalendarin e aktiviteteve shkencore institucioni organizon leksione të hapura, jashtë strukturës së programit mësimor ku studentët dhe pedagogët kane mundësi të njihen me zhvillimet e reja në fushën e shëndetit apo të shkëmbejnë eksperiencat dhe dijet tyre.</p> <p>Një ndër mënyrat që motivon studentët në asimilimin e programit mësimor është dhe puna e pavarur e studentit, puna në grup gjatë seminareve apo aktiviteteve trainuese të cila ju mundësojnë studentëve aftësitë organizuese dhe drejtuese, komunikimit me etike midis kolegëve.</p> <p>Në zhvillimin e procesit mësimor liria akademike që siguron institucioni, ju mundëson pedagogëve përdorimin e metodave të ndryshme në mësimdhënie, si dhe në punimin e temave të diplomës.</p> <p>Institucioni mbështet studentët në zhvillimin e ideve të tyre inovative apo realizimin e punimeve të ndryshme duke ju vënë në dispozicion laboratorët, bibliotekën e Universitetit apo sallat e kompjuteravë dhe asistencën nga stafi akademik. Studentët janë përfshirë në kryerjen e referimeve në aktivitetet që organizon departamenti, temave të kursit, projekte të ndryshme.</p> <p><i>(Takimi me studentët dhe stafin akademik)</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe</p>	<p>Gjatë vitit akademik në përputhje me kalendarin e aktiviteteve shkencore apo kalendarit të promovimit shëndetësor, departamenti i infermieristikës në bashkëpunim me departamentet e tjera të FSHMT si dhe mjekë nga institucione shëndetësorë apo institucione arsimore</p>

teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	vëndase dhe të huaj organizojnë seminare, konferenca apo leksione të hapura, tavolina të rumbullakta jashtë strukturës së programit mësimor ku studentët dhe pedagogët kanë mundësi të njihen me zhvillimet e reja në fushën e shëndetit apo të shkëmbejnë eksperiencat dhe dijet e tyre. Pjesmarrës në këto aktivitete janë dhe studentët. Institucioni disponon dokumentacion që vërteton realizimin e këtyre aktiviteteve. <i>(Takimi me studentë dhe pedagogë, evidenca 2.5 Të dhëna mbi aktivitetet 2021-2022)</i>			
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparura kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Institucioni mbështet financiarisht studentët për zhvillimin e temave të diplomës apo studime duke i financuar për pjesmarrjen në konferenca studentorë ndërkombëtare si dhe publikimin të punimeve të tyre në Buletinin Shkencor periodik. <i>(Takimi me studentë)</i>			
Konkluzione	<i>GVJ gjykon se standardi III.4 përmbushet plotësisht. Programi i studimit synon thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale në fushën e Mami-së. Proçesi mësimor realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike si leksione, seminare, detyra kursi, prezantime apo praktika. Studentët marrin formim të avancuar infermieror në fushën e obstetrikë-gjinekologjisë. Programi mësimor krahas lëndëve të formimit bazë në fushën e infermieristikës përmban dhe lëndë të formimit të përgjithshëm përmes të cilave synohet zhvillimi i aftësive në fushën e teknologjisë së informacionit, në fushën e komunikimit dhe ndërveprimit. Institucioni mbështet studentët në zhvillimin e ideve të tyre inovative apo realizimin e punimeve të ndryshme. Në funksion të një përgatitje të gjithanshme profesionale dhe të formimit të mendimit kritik, institucioni organizon në mënyrë periodike leksione të hapura apo konferenca shkencore me pjesmarrjen e mjekëve të shquar vendas apo të huaj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Studenti me përfundimin e studimeve paiset me diplomë Master Shkencor në "Mami" pasi ka shlyer të gjitha detyrimet e planit mësimor, detyrimet financiare dhe ka mbrojtur mikrotezën. Rregullorja e punimit të temës së diplomës mbart informacione të detajuara për mënyrën e shkrimit të temës së diplomës. Proçedura e provimit përfundimtar dhe mbrojtja e diplomës bazohet në rregulloren e UNIEL dhe të programit të

	<p>studimit. Komisioni vlerësimi ngrihet në bazë departamenti dhe përbëhet nga 5 anëtarë.</p> <p><i>(Evidencat 1.8 Rregullorja e programit të studimit, 3.13 Proçesverbal i provimit të formimit)</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Fokusi i programit MSH në “Mami” është përvetësimi i aftësive praktike profesionale dhe kompetencave në ushtrimin e profesionit nga ana e studentit. Bazuar në këtë qëllim provimi përfundimtar si detyrim përmbyllës, synon të testojë aftësitë e studentëve për të aplikuar njohuritë e përfituara në programin e studimit në përgatitjen e një teme diplome. Studentët asistohen nga pedagogët e programit të studimit për provimin përfundimtar dhe në zgjedhjen e temës së diplomës. Në përfundim të lëndës studentët orientohen nga pedagogët ku duhet të fokusohen gjatë përgatitjes së tyre për provimin si dhe literaturëm që do të shfrytëzojnë. Gjithashtu, pedagogët i asistojnë studentët me konsultime me kërkesë të studentët sipas grafikut të shpallur në fillim të semestrit gjatë orarit zyrtarë të punës.</p> <p><i>(Evidencat 1.8 Rregullorja e programit të studimit, 3.5 Manuali i punimit të diplomës)</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Studenti mbron diplomën pasi ka plotësuar të gjitha kreditet e programit të studimit. Vlerësimi final i studentëve bëhet përmes mbrojtjes së një teme diplome.</p> <p>Temat propozohen nga departamenti dhe lista e tematikave të propozuara i paraqiten studentëve dhe udhëheqësve të tyre. Zgjedhja e temës e cila ka karakter aplikativ/praktikë bëhet nga studenti dhe pedagogu udhëheqës.</p> <p>Mbrojtja realizohet para një komisioni të posaçëm të ngritur me propozim të drejtuesit të departamentit dhe të miratuar nga dekani i FSHMT.</p> <p><i>(Evidencat 1.8 Rregullorja e programit të studimit, 3.5 Manuali i punimit të diplomës)</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Në realizimin e temës së diplomës studentët asistohen nga pedagogët ndihma e të cilëve konsiston në zhvillimin e seancave konsultuese që janë orë pune që ndihmojnë studentin në hartimin e strukturës së temës, zgjedhjen e literaturës, metodologjinë e hartimit, shkrimin apo prezantim e punimit të diplomës. Seancat konsultuese zhvillohen nga pedagogu udhëheqës i temës dhe kanë karakter interaktiv. Institucioni vë në dispozicion të studentëve për realizimin e pjesës teorike të temës së diplomës infrastrukturën e nevojshme si dhe ju garanton studentëve mbledhjen e të dhënave apo realizimin e testeve të ndryshme në funksion të temës në institucionet shëndetësore me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p><i>(Evidencat 1.8 Rregullorja e programit të studimit, 3.5 Manuali i punimit të diplomës)</i></p>

<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Mikroteza ka 18 ECTS dhe llogaritet 450 orë mësimore prej të cilave 420 janë punë e pavarur e studentit.</p> <p>Përcaktimi i temave të diplomës bëhet nga departamenti ku zhvillohet programi studimit, në fillim të vitit të dytë akademik. Temat përcaktohen nga pedagogët në diskutim me studentët. Studentët asitohen nga pedagogët dhe stafi sekretarisë në caktimin e temës së diplomës, zgjedhjen e udhëheqësit dhe plotësimi e formularit të aplikimit për temën e diplomës. Aplikimet shqyrtohen në departament dhe miratohen nga dekani.</p> <p>Institucioni mbështet studentët në punën e pavarur për kryerjen e testimeve në ambientet e tij ose në ambientet e institucioneve me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi.</p> <p><i>(Evidencat 1.8 Rregullorja e programit të studimit, 1.13 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit, 4.7 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën)</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Pedagogu udhëheqës udhëzon dhe orienton studentin gjatë punimit të temës, mbledhjen e të dhënave dhe përpunimin e rezultateve, literatuën që do shfrytëzojë dhe jep miratimin me shkrim nëse studimi është i plotë për tu paraqitur përpara komisionit të vlerësimit. Studenti dorëzon punimin e diplomës pranë komisionit të posaçëm të vlerësimit i cili nëse ka, bën rekomandime të cilat pasqyrohen nga studenti. Komiteti shkencor i programit mer vendimin për mbrojtjen e temës dhe cakton datën e mbrojtjes e cila shpallet dhe publikisht. Mbrojtja bëhet përpara komisionit të caktuar nga komiteti shkencor i programit dhe miratuar nga përgjegjësi i departamentit. Vlerësimi bëhet me notë e cila është mesatare e vlerësimit të secilit prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit. Vlerësimi bazohet në disa kriteret si cilësia e punimit, struktura organizmit, shkrimi mënyra e zhvillimit të ideve, cilësia e analizës dhe rezultateve të studimit, mënyra e paraqitjes, literatura etj. Rezultati përfundimtar shënohet në Procesverbal dhe bëhet publik në fund të çdo seance të mbrojtjes së diplomave, në prani të diplomantëve. Vendimi i Komisionit të Vlerësimit të Diplomave është përfundimtar dhe nuk mund të ankimohet.</p> <p><i>(Evidenca 3.5 Manuali i punimit të diplomës)</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve studenti pajiset me diplomë dhe suplementin e diplomës pasi ka shlyer të gjitha detyrimet mësimore dhe financiare ndaj Universitetit. Diploma është sipas formatit të miratuar nga Ministria përgjegjëse për arsimin dhe nënshkruhet nga Dekani i Fakultetit dhe Rektori.</p> <p>Në përfundim të studimeve në këtë program, studenti pajiset dhe me një kopje të programit të studimit që ka zhvilluar në ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave në “Mami” Proçedura që ndiqet për</p>

	tërheqjen e programit të studimit përcaktohet në rregulloren e departamentit. <i>(Evidencat I.7 Rregullore e FSHMT, 2.14 Suplementi i diplomës 2.13 Model diplome)</i>								
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Dokumentacioni lidhur me studentin ruhet nga institucioni për një afat kohor të pacaktuar. Institucioni mund të japë informacion për studentët nëse kërkohet. Në sekretariatë mësimore të fakultetit gjëndet regjistri themeltar i studentëve, regjistri i vlerësimeve të mara nga studentët gjatë viteve të studimit në programin e studimit dhe regjistri i tërheqjes së diplomës dhe çertifikatave. <i>(Evidencat I.7 Rregullore e FSHMT, 3.6 Rregullore për krijimin regjistrimin ruajtjen shërbimin dorëzimin e dokumentave në UNIEL, 3.7 Funkcionet dhe kompetencat e sekretarise mësimore të FSHMT, Evidenca 2.14 Modeli i suplementit të diplomës, 2.13 Model diplome).</i>								
Konkluzione	<i>GVJ gjykon se Standardi III.5 përmbushet plotësisht.</i> Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit Master Shkencor në "Mami" dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës. Në përfundim të studimeve studenti pajiset me diplomë dhe suplementin e diplomës pasi ka shlyer të gjitha detyrimet mësimore dhe financiare ndaj Universitetit.								
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në "Master Profesional" institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfitim të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	<i>Programi i studimit nuk është Master Profesional.</i> Njësitë përgjegjëse për realizimin e programit të studimit është departamenti i Specialiteteve Tekniko-Mjekësore në FSHMT, UNIEL. Institucioni ka siguruar infrastrukturën e nevojshme për realizimin e praktikës mësimore në ambientet e FSHMT (si laborator i dixhital i anatomisë, laborator i infermierisë, paisje të ndryshme mjekësore për aftësimin profesional të studentëve) si dhe marrëveshje me institucione shëndetësore për kryerjen e praktikës profesionale të studentëve. <i>(Evidencat 1.13 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit, 1.14 Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave, 4.7 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e fakultetit)</i>
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave	Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet shëndetësore shërbejnë studentit për përfitim të kompetencës profesionale, aftësive për menaxhimin e situatave të ndryshme infermiore, zgjidhjen e situatave

klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	të ndryshme të pacientëve, përdorimin e paisjeve të ndryshme mjekësore dhe teknologjisë bashkëkohore. <i>(Evidencat 1.13 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit)</i>								
Kriteri 3. Praktikë profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Praktika profesionale ka 16 ETCS ose 320 orë mësimore në auditor. Në fund të praktikës bëhet vlerësimi me notë sipas udhëzuesit të praktikës profesionale. <i>(Evidence 1.14.2 Proçesverbali i praktikës)</i>								
Konkluzione	<i>GVJ gjykon se Standardi III.6 përmbushet plotësisht. Institucioni ka siguruar infrastrukturën e nevojshme për realizimin praktikës mësimore në ambientet e FSHMT si dhe marrëveshje me institucione shëndetësore për kryerjen e praktikës profesionale të studentëve. Praktika profesionale ka 16 ECTS ose 320 orë mësimore. Në fund të praktikës bëhet vlerësimi me notë sipas udhëzuesit të praktikës profesionale.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1 Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për	Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi në përgjithësi ka përgatitjen profesionale, eksperiencën dhe ekspertizën e duhur mjeksore dhe pedagogjike në lëndët që mbulon. Referuar tabelave 1 dhe 2 të RVB, në vitin akademik 2021 – 2022, njësia bazë përbëhet nga 8 anëtarë PAE dhe përfshin në mësimdhënie dhe 25

nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

anëtarë PAK. Kualifikimi i personelit akademik të përfshirë në mësimdhënie është:

PAE	PAK
Tituj/Grada	Tituj/Grada
(3) Prof. Asc.	(3) Dr
(2) Dr	(22) Msc
(2) Dr ne proçes	
(1) Msc	

Sipas tabelës 2 të RVB personeli akademik i njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit për dy vite akademike paraqitet si më poshtë:

Tituj/ grada	2021-2022		2020-2021	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	0	0	0	0
Prof.Asc.	2	0	2	0
Dr./PhD.	1+1*	3	1+1*	2
Msc.	3	16	3	22
Totali	7	19	7	24
* Doktoraturë në proçes				

(Tabela 7 Të dhënat përmblledhëse të stafit. Tabela 2 CV të stafit akademik . 1.1 Statuti i UNIEL)

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Nga vlerësimi i dokumentacionit si Plani mësimor, angazhimi i stafit akademik për vitin 2021-2022, CV të stafit akademik dhe Programet lëndore, rezulton se personeli akademik efektiv, mbulon ngarkesën mësimore në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, në shumicën e rasteve.

Përlllogaritja e ngarkesës mësimore që mbulon personeli akademik efektiv është bazuar në kombinimin e Tabelës 4 (këtu janë nxjerrë ngarkesa mësimore (orë), Tablela 6, ku jemi bazuar për Personelin Akademik Efektiv, ndërsa Tabela 12.1 ka mospërputhje me 2 tabelat e sipërpërmendura.

POR, GVJ KONSTATON SE:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit si CV e stafit akademik, Planit mësimor, Tabelat 4, 6.1, 6.2 të RVB, GVJ konstatoi se:

- *formimi profesional jo gjithmonë përputhet me lëndën që zhvillon në këtë program studimi. P.sh. mjek i sapodiplomuar Msc në Mjekësi të përgjithshme jep lëndë specialistike si gjinekologji invazive, pedagogë*

	<p><i>të diplomuar në infermieri të përgjithshme apo menaxhim infermieror japin lëndë të profileve specifike në obstetrikë-gjinekologji.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>Ka pedagogë që japin më shumë se tre lëndë dhe ngarkesa mësimore e tyre është mbi normën e parashikuar nga legjislacionit në fuqi.</i> • <i>Ka pedagoge lektorë të kategorisë Msc, kur legjislacioni përcakton që lektorët duhet të zotërojnë gradën "Doktorë Shkence".</i> <p><i>Tabela 2- Personeli akademik efektiv dhe me kontratë që mbulon programi i studimit MSh ne Mami) .</i></p> <p><i>(EVIDENCA 2.13 Modeli i diplomes se programit te studimit MSh në Mami)</i></p> <p><i>Tabela 12 -Plani mesimor i lidhur me personclin akademik përkatës.</i></p> <p><i>Tabela 6 – Cilësia e stafit mësimdhënës për programin e studimit.</i></p> <p><i>Tabela 4 – Ngarkesa totale e personelit akademik të programit Master i Shkencave në Mami në një vit akademik.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Institucioni pajis me kontratë punësimi personelin akademik, duke siguruar qëndrueshmërinë e personelit efektiv në periudhën e akreditimit. Personli nënshkruan kontratën individuale të punës, në të cilën janë të mbuluara edhe sigurimet shoqërore e shëndetësore.</p> <p><i>(EVIDENCA 4.1 Listepagesa e personelit Janar-ershor 2022</i></p> <p><i>(EVIDENCA 4.2 rregullore e modaliteteve te rekrutimit te personelit akademik UNIEL).</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Procedura e rekrutimit bazohet në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, si edhe në Rregulloren e Institucionit. Ajo bazohet në kriteret të përgjithshme dhe specifike për vlerësimin dhe përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur akademik. Departamenti është njesia bazë që inicion kërkesën për mbulimin e vakancave, duke përcaktuar edhe kriteret e posaçme në varësi të pozicionit. Pasi merret miratimi nga Dekani, Zyra e Burimeve Njerëzore procedon me publikimin dhe pritjen e kandidatave, të cilat kalojnë në vlerësimin e komisionit ad-hoc. Në përzgjedhjen e kandidatëve zbatohen me korrektësi të gjitha elementet e rregullores, duke respektuar kriteret e përgjithshme dhe të posaçme, e mandej në mënyrë transparente përzgjidhet kandidati fitues.</p>
	<p>GVJ zhvilloi vizitë në Zyrën e Burimeve Njerëzore, ku konfirmohet rregullsia në dokumentacion, si për stafin akademik efektiv, edhe për atë me kohë të pjeshme.</p>

	<p><i>((EVIDENCA 4.2 Rregullore e modaliteteve te rekrutimit te personelit akademik UNIEL</i></p> <p><i>(EVIDENCA 4.3 Rregullore e modaliteteve te rekrutimit t personelit ndihmes akademik</i></p> <p><i>(EVIDENCA 4.4 Rregullore e rekrutimit te personelit administrativ)</i></p> <p><i>Vizita në Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe Protokoll- Arkivës.</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Në realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratoreve, institucioni ka punësuar personel ndihmës akademik- laborant, konkretisht për laboratorin e Infermierisë dhe Anatomisë.</p> <p><i>(EVIDENCA 1.11 Struktura organizative e UNIEL</i></p> <p><i>(EVIDENCA 1.8 Rregullore e programit te studimit Master Shkencor ne Mami</i></p> <p><i>(EVIDENCA 2.9 Plani mësimor.)</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Zyra e Burimeve Njerëzore, e cila funksionon konform Rregullores së UNIEL, ruan dhe përditëson të gjitha dosjet e personelit akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme. Nga vizita zhvilluar në ambientet e UNIEL dhe takimi me përgjegjësen e Zyrës së Burimeve Njerëzore, GVJ u njoh me dosjet individuale të stafit dhe evidentoi ruajtjen dhe përditësimin e dokumentave të nevojshme për secilin peagog, të angazhuar konform shpërndarjes së ngarkesës mësimore, sipas planit të programit të studimit Master i Shkencave në “Mami”.</p> <p><i>(EVIDENCA 4.5; Tabela 3,4. Tabela treguese e angazhimit te personelit akademik për vitin akademik 2021-2022, lëndët dhe ngarkesa perkatese)</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>FSHMT dhe UNIEL ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Qendrën Spitalore “Dr. Xhafer Kongoli”, me Spitalin Psikiatrik “Dr. Sadik Dinçi”, me Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetsor dhe Drejtorinë Rajonale të Shëndetit, Elbasan, me qëllim realizimin e procesit mësimor, vecanërisht praktikave mësimore. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ, konstatoi se ka përfunduar afati i marrëveshjeve ndaj GVJ:</p> <p><i>Rekomandon rinovimin e marrëveshjeve të bashëpunimit midis UNIEL dhe institucioneve shëndetsore.</i></p> <p><i>(Tabela 5 Institucionet dhe organizatat bashkëpunuese për Praktikrat Profesionale.)</i></p>

<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Në mjediset shëndetësore të institucionve me të cilat UNIEL ka marrëveshje, studentët zhvillojnë praktikat mësimore, të mbikqyrur nga personeli shëndetësor, si edhe anëtari i stafit akademik i ngarkuar për praktikat mësimore. GVJ i është vënë në dispozicion dosja e praktikës për programin e studimit Master i Shkencave në “Mami”, në plotësimin e secilës zhvillohen aftësi të përcaktuara infermierore.</p> <p><i>(EVIDENCA 1.14.1 Paketa e praktikës për programin e studimit)</i></p> <p><i>(EVIDENCA 2.9 Plani mësimor i programit të studimit Master Shkencor në Mami)</i></p> <p><i>Tabela 5- Institucionet dhe organizatat bashkepunuese në rang programi/esh studimi për praktikat profesionale me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale.</i></p> <p><i>EVIDENCA 1.4 Lista e marrëveshjeve për zhvillimin e praktikave</i></p> <p><i>(EVIDENCA 4.1 Listepagesa e personelit janar-gershor 2022 FSHMT 2.xlsx)</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se Standardi 4.1 përmbushet kryesisht.</i></p> <p><i>Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standartet sasore dhe me së shumti ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik.</i></p> <p><i>GVJ, sugjeron që leksionet të zhvillohen nga pedagogë me gradën “Doktor”, si edhe lëndë të specialiteteve të jepen nga specialistë të fushës.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ u njoh me mjediset e FSHMT, ku zhvillon aktivitetin njësisht bazë, sallat e leksioneve, seminareve, laboratoreve, si edhe zyrat. Mjediset janë të përshtatshme dhe të mjaftueshme – sipas mendimit të stafit akademik. Në diskutim vihet</p>

<p>specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>numri gjithnjë në rritje të studentëve të këtij fakulteti që <i>kërkon shtimin e kapacitetit mjedisor të këtij fakulteti.</i></p> <p><i>Ky është një sugjerim i GVJ që shkon paralel me planet e institucionit, për të ndërtuar një godinë të re brenda kampusit spitalor, në mikpritje dhe koherencë të kërkesave në rritje për këtë fakultet.</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedisë të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Mjediset e FSHMT janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit që garanton realizimin e procesit mësimor përmes teknologjive bashkëkohore dhe metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies e mësimnxënies.</p> <p><i>(Evidenca 4.8 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratorëve TIK. Vizita në institucion).</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Gjatë vizitës në Institucion, GVJ u njoh me laboratorët e Fakultetit, por këtë kriter nuk mund ta vlerësojmë pasi Curricula e programit të studimit Master i Shkencave në “Mami”, nuk përmban orë laboratorit.</p> <p><i>(Vizita në institucion. Evidenca 4.8. Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e laboratorëve.)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>GVJ vizitoi edhe laboratorin e TIK- pjesë e FSHMT, i cili përmban programe profesionale të aksesueshme nga studentët e këtij programi studimi.</p> <p><i>(Vizita në institucion. Evidenca 4.9. Të dhëna mbi kapaciteti dhe infrastrukturën e laboratorëve TIK.)</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe</p>	<p>Departamenti nuk e disponon</p>

ambulatorë me kapacitetet e nevojshme.				
Konkluzione	<i>GVJ, vlerëson se standardi IV.2 përmbushet plotësisht.</i>			
	<i>Bazuar në materialet e vëna në dispozicion dhe vecanërisht në vizitën që GVJ zhvilloi në institucion, jemi të mendimit se UNIEL ka vënë në dispozicio të këtij programi studimi mjedise mësimore dhe infrastruktuë të përshtatshme për realizimin e procesit mësimor, si dhe për formimin praktik, në përputhje me natyrën dhe fushën e programit të studimit. GVJ, është i mendimit se infrastruktura shfrytëzohet maksimalisht, ndaj sugjeron shtimin e kapaciteteve strukturore dhe laboratorike për të ecur paralel me kërkesat në rritje për këtë program studimi.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Literatura bazë dhe ndihmëse, e përcaktuar në syllabuset lëndore, garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme sipas fushave specifike të lëndëve përkatëse. Literatura e sugjeruar gjendet në formë fizike apo elektronike dhe vihet në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (në shqip). <i>(Evidencat: 2.7 Anëtarësimi në J STORE dhe U-Library; 2.8 Fondi i librit; 4.11.1 Blerjet e fondit të bibliotekës.)</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet e literaturës me botime të viteve të fundit.	Mbi përditësimin e literaturës bazë dhe ndihmëse, GVJ vëren se në disa raste në programet lëndore rekomandohet literaturë e vjetër ose mungon viti i botimit. Nga biseda me stafin, pedagogët shprehën se përditësojnë leksionet e tyre (dispencat) me literaturë bashkëkohore, si një mundësi për të qënë më fleksibël në përditësimin e literaturës për studentët. <i>Edhe pse shohim përpjekje të njësive bazë për përditësimin e literaturës, jemi të mendimit se ka mangësi në pasqyrimin e literaturës bashkëkohore.</i> <i>(Evidencat: 2.7 Anëtarësimi në J STORE dhe U-Library; 2.8 Fondi i librit; 4.11.1 Blerjet e fondit të bibliotekës. Vizita në institucion.)</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	UNIEL ve në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore të FSHMT, si dhe Bibliotekën e Universitetit në korpusin universitar qëndror. Në patëm mundësinë t'i vizitojmë këto dy mjedise, të cilat po i nënshtrohen rikonstruksionit, si dhe avancimit teknologjik dhe digjitalizimit. Nuk patëm mundësi të shohim fizikisht fondin e librave,

	<p>pasi mjediset ishin në proces ristrukturimi. Nga evidencet e vëna në dispozicion vlerësojmë se, studentëve u krijohet mundësia të shfrytëzojnë fondin fizik dhe dixhital të librit në mënyrë të barabartë. Përkohësisht mjediset ishin jashtë shërbimi dhe pedagogët na komunikuan se dispencat e tyre studentët mundet ti gjenin pranë sekretarisë, e cila lehtëson dhe ju vjen në ndihmë studentëve.</p> <p><i>(Evidenca 4.11 Të dhëna mbi orarin e shërbimit të bibliotekës, Vizita në institucion.)</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në përshkrimin e RVB, biblioteka e UNIEL është e pajisur me literaturë fizike, si tekste mësimore dhe literaturë tjetër ndihmëse në gjuhën shqipe dhe atë të huaj .GVJ nuk mundi të vlerësojë fizikisht fondin fizik të bibliotekës, pasi mjedisi ishte në proces ristrukturimi. Gjithashtu evidenca Fondi i librit nuk na munëson të përcaktojmë me detaje mbi titujt e librave apo revistave shkencore në dispozicion të programit të studimit Master i Shkencave në “Mami”.</p> <p><i>(Evidenca 2.8 Fondi i librit; Vizita në institucion.)</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni garanton shfrytëzim të barabartë dhe pa pagesë për të gjithë studentët në bibliotekat online për fushën e programit të studimit Master i Shkencave në “Mami” Studentët mundet të anëtarësohen në J STORE dhe U-Library, vullnetarisht dhe pa pagesë.</p> <p><i>(Evidenca 2.7 Anëtarësimi në J store dhe U-Library.)</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>GVJ, përgjatë vizitës në institucion, konstatoi se ristrukturimi i bibliotekës ishte një proces që e pajis atë me teknologjinë bashkëkohore digjitale dhe krijon mundësi shumë të favorshme në një të ardhme të afërt.</p> <p><i>(Evidenca 4.10 Dokumenti për njoftimin e projektit për digjitalizimin e Bibliotekës UNIEL; Vizita në institucion.)</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>GVJ konstatoi se biblioteka e UNIEL vihej në dispozicion të studentëve, me orare shërbimi në përshtatje me oraret e studimit dhe përtej tyre. Por biblioteka e FSHMT vihej në dispozicion të studentëve me orar të kufizuar 8:00-15:00, pasi nuk kishte një punonjës bibliotekë në personel. Ky shqetësim pasqyrohet në RVB, si edhe përgjatë vizitës sonë në Institucion, në takimet me drejtuesin e njësisë bazë dhe stafin.</p> <p><i>(Evidenca 4.11 Të dhëna mbi orarin e shërbimit të bibliotekës UNIEL; Vizita në institucion.)</i></p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online</p>	<p>Në përmbushje të këtij kriteri mbi cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online, përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik ose online nga personeli akademik dhe studentët e programit të studimit</p>

<p>(titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Master i Shkencave në “Mami”, shfrytëzimin e sallave të studimit dhe eficiencën e përpjekjeve të pasurimit të fondit fizik dhe online, RVB evidenton në materialin e analizës vjetore institucionale të UNIEL, por kjo është analizë e vetme që i përket vitit 2021 dhe mungojnë të dhëna të përditësuara për vitin në vazhdim. (Evidenca 1.12 Analiza vjetore institucionale 2020-2021.)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ, vlerëson se standardi IV.3 përmbushet kryesisht. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të programit të studimit Master i Shkencave në “Mami” është në përputhje me fushën e studimit, por ka vend për përmirësime për të qenë bashkëkohore. Po ashtu, edhe të dhënat mbi fondin fizik të librit nuk janë të plota dhe të sakta. Në programet lëndore mungojnë apo janë të vjetëruara literaturat e sugjeruara (pjesërisht). Ndërkohë që mjediset e bibliotekës po i nënshtrohen procesit të ristrukturimit, duke ofruar në një të ardhme të afër një bibliotekë dixhitale moderne dhe me fond fizik të librit. Studentëve dhe stafit u mundësohet pa pagesë dhe në mënyrë të barabartë regjistrimi dhe shfrytëzimi i bibliotekës online në J STORE dhe U-Library. Orari i bibliotekës së FSHMT ngelet problem që duhet zgjidhur në të ardhmen.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Në paraqitjen e RVB, si edhe përgjatë vizitës në Institucion, në takimet me Shefin e Departamentit, Stafin dhe Sekretarinë Mësimore, konstatojmë se UNIEL disponon sistem të menaxhimit, nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët, si dhe aktivitetin e tyre që nga regjistrimi deri në diplomim. Informacioni i ruajtur në regjistra në formë manuale, nga regjistrat e kursit deri në regjistrat e sekretarisë mësimore, si dhe informacioni në formë elektronike (porocesverbalet në sistemin EMS dhe në hard-copy) figuron i rregullt.</p>

	<i>(Evidencat 4.12 Rregullorja EMS; 3.7 Funkcionet dhe kompetencat e sekretarisë mësimore në FSHMT; Vizita në institucion.)</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	GVJ, konstaton se, nëpërmjet sistemeve të brendshme të menaxhimit EMS dhe UNIEL.EDU.AL, administrohet informacioni dhe dokumentacioni i të gjithë aktorëve dhe partnerëve të angazhuar në procesin mësimor, personel akademik, ndihmës akademik, administrativ, në realizimin e programit. <i>(Evidenca 4.12 Rregullorja EMS; Vizita në institucion.)</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	GVJ, konstaton se në respekt të kuadrit ligjor dhe mbrojtjes së të dhënave personale, sistemi i menaxhimit garanton dhe siguron akses të dedikuar në informacione dhe dokumente, për të gjithë personelin dhe studentët e Programit të studimit Master i Shkencave në “Mami”. <i>(Evidencat: 4.12 Rregullorja EMS; 4.13 Të dhëna mbi publikimin në faqen e WEB.)</i>
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Nëpërmjet sistemeve të menaxhimit EMS dhe UNIEL.EDU.AL mundësohet komunikimi interaktiv , i shpejtë dhe i saktë i informacionit në lidje me procesin mësimor, lerësimet, kreditet, mbarëvajtjen e procesit mësimor. Ndërkohë që, nëpërmjet platformave Model uniel.edu.al, Microsoft Teams dhe grupeve whatsapp, realizohen komunikime dhe shkëmbime të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentve. <i>(Evidenca : 6.1 Guida e pedagogut : mësimi online nëpërmjet Microsoft Teams; 4.12 Rregullorja EMS.)</i>
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	GVJ, vëren se, edhe në sajë të digjitalizimit, sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ, si edhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale, për organet drejtuese dhe autoritetet drejtuese të UNIEL. <i>(Evidenca: 4.12 Rregullorja EMS.)</i>
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Në WEB faqen e UNIEL, informacionet që lidhen me Programin e studimit Master i Shkencave në “Mami”, personelin akademik, aktivitetet institucionale publikohen në Gjuhën Shqipe dhe Angleze. <i>(Evidenca 4.13 Të dhëna mbi publikimin në faqen WEB.)</i>
Konkluzione	<i>GVJ, vlerëson se Standardi IV.4 përmbushet plotësisht. UNIEL disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional, i cili edhe në sajë të digjitalizimit, vihet në dispozicion të administrimit,</i>

	<i>informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ, për programin e studimit Master i Shkencave në "Mami", duke përmbushur plotësisht Standardin.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ i është vënë në dispozicion evidenca me të dhëna mbi koston e programit të studimit, plani për mbështetjen financiare për një cikël të plotë studimi. Gjithashtu, disponojmë edhe evidencat me miratimin e Buxhetit 2022 nga Bordi i Administrimit, miratimi i Regjistrit të prokurimeve dhe shërbimeve. Duke qenë institucion publik, UNIEL i siguron fondet nga buxheti i shtetit dhe të ardhurat e Universitetit. <i>(Evidencat: 4.17 Të dhëna që lidhen me koston e programit të studimit, plani për mbështetjen financiare për një cikël të plotë studimi. 4.14 Miratimi i Buxhetit 2022; 2.3 Miratimi Buxhetit 19-20-21 4.15 Miratimi i regjistrit të prokurimeve dhe shërbimeve.)</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Mbështetur në RVB dhe në evidenca, vërejmë se në fund të çdo viti akademik njësi bazë harton një raport financiar dhe në çdo fillim viti akademik harton planin për mbështetje financiare të njësisë me zëra për mirëmbajtje mjedisore, mbështetje në teknologji, aktivitete, literaturë, akses në biblioteka online, etj. <i>(Evidencat: 4.17 Të dhëna që lidhen me koston e programit të studimit, plani për mbështetjen financiare për një cikël të plotë studimi.)</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Konform legjislacionit në fuqi, UNIEL i nënshtrohet në vazhdimësi auditimit periodik, të bazuar mbi dokumentacionin. <i>(Evidenca: 4.14 Raporti i Auditit KLSH 2022)</i>

<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Në përmbushje të këtij kriteri, citojmë nga RVB se: Njësia bazë njihet me raportin financiar të institucionit, i cili u bëhet me dije të anëtarëve të njësisë bazë. Raporti është i aksesueshëm edhe në faqen zyrtare https://www.uniel.edu.al <i>(Pasqyrohet në evidencën Analiza vjetore institucionale e DSTM 2020-2021. Por nuk kemi evidencë për 2021-2022 Evidenca 1.12.1 Analiza Vjetore Institucionale 2020-2021)</i></p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Si institucioni publik, me numër të konsiderueshëm studentësh dhe programe studimi; UNIEL garanton qëndrueshmëri financiare në zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë si edhe kapacitete financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. <i>(Evidencat: 4.14 Miratimi i Buxhetit 2022 4.15 Miratimi i regjistrit të prokurimeve dhe shërbimeve. Mungon Miratimi i Buxhetit 2023.)</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se standardi IV.5 përmbushet plotësisht. GVJ ka bindjen dhe gjen në evidenca dhe raporte se UNIEL garanton financimin dhe mbështet financiarisht realizimin e procesit mësimor dhe kërkimor dhe siguron mbarëvajtjen e programit Master i Shkencave në "Mami", si edhe mbështetjen e studentëve.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht X</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------------	------------------------------

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<p>Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>

<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>GVJ konstaton se, Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura të cilat mbulojnë ciklin e plotë të studimeve Master i Shkencave në “Mami”, që nga momenti i regjistrimit deri në diplomim, në përputhje me aktet e veta normative dhe rregullatore të përcaktuara në Statutin e UNIEL, Rregulloren e FSHMT, Rregulloren e Programit të Studimit Master i Shkencave në “Mami” si dhe tërësinë e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi në RSH.</p> <p><i>(Evidencat: 1.1 Statuti i UNIEL, 1.7 Rregullore e FSHMT, 1.8 Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në “Mami”</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstaton se, politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë, gjithëpërfshirjen dhe mosdiskriminimin, për të gjithë kandidatët dhe mandej studentët e programit të studimit Master i Shkencave në “Mami”. Në auditorët e FSHMT ofrohen facilitete për aksesueshmërinë e tyre nga persona me aftësi ndryshe.</p> <p><i>(Evidencat: 1.7 Rregullore e FSHMT, 1.8 Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në “Mami”</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>GVJ konstaton se UNIEL harton dhe publikon përpara çdo viti akademik, kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Këto kritere miratohen me vendim Senati, i cili publikohet online në faqen e web-it të UNIEL. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, bazuar në ligjin dhe udhëzimet përkatëse të MAS. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj vërtetojmë se për këtë program studimi nuk ka kritere specifike.</p> <p><i>(Evidencat: 1.8.1 Vendimi për miratimin e kritereve të pranimit për programin e studimit Master i Shkencave në “Mami” 1.8.2 Vendimi për miratimin e kuotave të pranimit për programin e studimit Master i Shkencave në “Mami” 5.1 Vendimi i Senatit Akademik për kapacitetet 2022-2023.)</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Në RVB thuhet dhe ne biem dakort se kriteret, procedurat e përzgjedhjes dhe pranimit të studentëve, përparimin gjatë kursit të studimit, transferimi, njohja e studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, vlerësimi i dijeve dhe diplomimi, janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku i gjerë, pasi janë të përcaktuara në rregulloren e FSHMT, si dhe mund të aksesohen lehtësisht në çdo kohë online në websit-in e UNIEL</p> <p><i>(Evidencat: 1.2 Rregullore e studimeve UNIEL; 1.7 Rregullore e FSHMT; 1.8 Rregullore e Programit të studimit “Bacheor në Infermieri-Mami”</i></p>


<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Përpara fillimit të çdo viti akademik, në afatet kohore të përcaktuara nga MAS, në UNIEL organizohen ditët e informimit të maturantëve. Informacioni jepet në takimet që organizon stafi i ngarkuar për promocion, shpërndahen fletëpalosje me informacionin e nevojshëm apo gjenden në faqen e webit të UNIEL. (Evidencat: 5.2 <i>Kalendari i ditëve të hapura</i> 4.13 <i>Të dhëna të publikuara në faqen e Web</i> 5.4 <i>Fletpalosje promovuese institucionale</i> 2.5 <i>Të dhëna mbi aktivitetet 2021-2022</i>)</p>			
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>GVJ, gjen se, UNIEL parashikon kuota të posaçme dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi ndryshe, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. (Evidenca: 5.1 <i>Vendimi i Senatit Akademik për kapacitetet 2022-2023</i>, 1.8.1 <i>Vendimi për miratimin e kriterëve të pranimit për programin e studimit Master i Shkencave në "Mami"</i> 1.8.2 <i>Vendimi për miratimin e kuotave të pranimit për programin e studimit Master i Shkencave në "Mami"</i>)</p>			
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>GVJ, gjen se, UNIEL harton dhe publikon kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. (Evidenca: 5.1 <i>Vendimi i Senatit Akademik për kapacitetet 2022-2023</i>, 1.8.1 <i>Vendimi për miratimin e kriterëve të pranimit për programin e studimit Master i Shkencave në "Mami"</i> 1.8.2 <i>Vendimi për miratimin e kuotave të pranimit për programin e studimit Master i Shkencave në "Mami"</i>)</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>GVJ, vërteton se UNIEL harton politika të ndihmës/bursave dhe në çdo fillim viti akademik kryen procedurat përkatëse të ndihmës dhe bursave për shtresat në nevojë, sipas vendimit të Bordit të Administrimit UNIEL. (Evidenca 2.1 <i>Vendimi i Bordit të Administrimit për bursat dhe përjashtimet</i>)</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ përcakton se Standardi përmbushet plotësisht, pasi UNIEL harton, ndjek dhe zbaton procedura konkrete për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve, në përputhje me legjislacionin në RSH, aktet ligjore dhe nënligjore, mbështetur në Rregulloret përkatëse Institucionale.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

Standardi V.2

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-13423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al



Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	GVJ, vëren se institucioni ve në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Të dhënat publikohen në faqen e web-it të UNIEL, afishohen në mjediset e FSHMT pranë tabelës së njoftimeve. Në çdo fillim viti akademik, studentët informohen për kriteret e kalimit nga një vit akademik në tjetrin, numrin e krediteve të nevojshme, ndërsa mbi rezultatet e provimeve njoftohen nëpërmjet sistemit EMS. Informacioni mbi ecurinë e studentëve disponohet edhe nga Zyra e Këshillimit të Karrierës e cila ua ofron palëve të interesuara. <i>(Evidencat: 1.2 Rregullorja e Studimeve UNIEL 1.7 Rregullore e FSHMT, 1.8 Rregullore e Programit të studimit Master i Shkencave në "Mami".)</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Bazuar në Rregulloren e Studimeve UNIEL dhe Rregulloren e FSHMT, institucioni informon studentët mbi kriteret dhe procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme, ose studimeve të pjesshme, aktivizon Komisionin e ekuivalentimit të moduleve dhe programeve ngritur në Departament, i cili bën vlerësimin e dosjeve dhe rankimin e kandidatëve sipas kriterëve të parashikuara dhe harton listën përfundimtare me vlerësimet për secilin kandidat. <i>(Evidencat: 1.2 Rregullorja e Studimeve UNIEL 1.7 Rregullore e FSHMT, 1.8 Rregullore e Programit të studimit Master i Shkencave në "Mami".)</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Bazuar në Rregulloren e Programit të studimit Master i Shkencave në "Mami" si dhe në Programet lëndore, në çdo fillim viti akademik, Përgjegjësi i Departamentit dhe pedagogët e moduleve përkatëse informojnë studentët mbi procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve e më specifikuat me elementët e vlerësimit të njohurive, pikëzimin dhe konvertimin në notë. <i>(Evidencat: 1.8 Rregullore e Programit të studimit Master i Shkencave në "Mami" 2.12 Programet lëndore të Programit të studimit Master i Shkencave në "Mami")</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Në fillimin e vitit të fundit të studimeve, bazuar në rezultatet e dy viteve të para, bëhet përzgjedhja e studentëve që plotësojnë kriteret e mbrojtjes së diplomës më temë. Udhëheqësi i temës së diplomës, i përcaktuar nga njësia bazë, përgatit programin e punës dhe ndjek procesin e konsultimeve me studentin kandidat për t'u diplomuar. Secili student

	mundet të aksesojë pranë faqes së UNIEL edhe manualin për pranimin e diplomës. Studentët e tjerë që nuk të plotësojnë kriteret, i nënshtrohen provimit përfundimtar të formimit. <i>(Evidencat: 1.7 Rregullore e FSHMT: 1.8 Rregullore e Programit të Studimit Master i Shkencave në "Mami"; 3.5 Manuali i punimit të diplomës).</i>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Në lidhje me promocionin për këtë program studimi dhe për çdo program tjetër, GVJ konstaton se, UNIEL organizon takime të hapura informimi, publikon një spot promovues për programet e studimit që ofron si dhe shpërndan fletëpalosje në çdo fillim viti. Gjithashtu nëpërmjet faqes zyrtare, sekretarive dhe stafit akademik ofron informacion të vazhdueshëm për publikun e interesuar. <i>(Evidencat: 5.3 Publikimi i spotit promovues 5.2 Kalendarit i ditëve të hapura 2022 5.4 Fletëpalosjet promovuese institucionale)</i>			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se Standardi V.2 përmbushet plotësisht.</i> <i>UNIEL ve në dispozicion të studentëve informacion të plotë dhe të detajuar mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundimin e studimeve në programin e studimit Master i Shkencave në "Mami"</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	GVJ, vëren se, informacioni për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit, transmetohet tek studentët nëpërmjet faqes zyrtare, zyrës të sekretarisë mësimore, personave prgjegjës në departament, nga momenti kur kandidatët për studentë paraqesin interes në vazhdimësi. <i>(Evidencat: 1.8 Rregullore e Programit të studimit Master i Shkencave në "Mami"</i> 4.13 Të dhëna mbi publikimin në faqen WEB)
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/	Në fillim të cdo viti akademik, përgjegjësi i Departamentit dhe pedagogët e lëndëve përkatëse informojnë studentët për modulet, lëndët,

<p>udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>përmbajtjen, numrin e krediteve për çdo lëndë, si dhe veprimtarinë formuese. Studentët aksesojnë të dhënat nëpërmjet llogarisë së dedikuar të EMS. Githashtu, informacioni gjendet i publikuar në faqen e WEB-it të UNIEL sipas zërave përkatës. Në vazhdimësi studentët asistohen edhe nga sekretaria mësimore. <i>(Evidencat: 4.12 Rregullorja EMS; 4.13 Të dhëna mbi publikimin në faqen e WEB.)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Nëpërmjet Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe i promovon në tregun e punës nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme si veprimtari jashtë mësimore. Krijimi i Bordit Këshillimor i Biznesit, krijon mundësinë që studentët të njihen me kërkesat e punëdhënësve si dhe të përfitojnë nga programi i nxitjes së punësimit. <i>(Tabela 5. Lista e aktiviteteve të Bordit Këshillimor të Biznesit 2021-2022; Evidenca 5.6 Të dhëna mbi studentët përfitues të programit të nxitjes së punësimit, https://www.uniel.edu.al universiteti-ue-drejtortë-drejtoria juridike-këshillimit-të karrierës-dhe alumni)</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Studentëve të sapoardhur në cdo fillim viti akademik, u jepet informacion i gjerë dhe i detajuar mbi mënyrën e organizimit të procesit mësimor në leksione-seminare-labratore, logjistikën infrastrukturën e FSHMT- sallat e leksioneve-seminareve-laboratorëve dhe shërbimet ndihmëse, si dhe organizimi i praktikave profesionale. Në orarin mësimor pasqyrohen të dhënat e nevojshme. Ai afishohet në tabela e njoftimeve në mjediset e FSHMT dhe u dërgohet studentëve në formë elektronike. <i>(Evidenca: 4.6, 4.7 Të dhëna mbi kapacitetet dhe infrastrukturën e Fakultetit dhe laboratorit TIK 4.13 Të dhëna mbi publikimin në faqen e WEB) Takimi me stafin</i></p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Nëpërmjet llogarisë personale në platformën EMS, studentët mund të marrin informacion të përditësuar mbi programin e studimit, modulet dhe lëndët, pedagogët përgjegjës dhe rezultatet në provime. Nëpërmjet adresës personale në platformën uniel.edu.al, të aksesueshme kudo dhe në cdo kohë, studentët mund të komunikojnë edhe me stafin akademik. <i>(Evidenca: 4.12 Rregullorja EMS; 4.13 Të dhëna mbi planifikimin në faqen e WEB; Takimi me stafin)</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se Standardi V.3 përmbushet plotësisht. UNIEL, vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit si dhe rezultatet e të nxënit dhe mundësitë e punësimit.</i></p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	UNIEL disponon statistika vjetore për numrin e studentëve dhe të diplomuarve në programin e studimit Master i Shkencave në “Mami”. Njësitë që i disponojnë këto të dhëna janë Sekretaria mësimore, njësia bazë, si dhe Njësia e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI. <i>(Tabela 21. Cilësia në hyrje dhe dalje të dtudentëve në programin e studimit Master i Shkencave në “Mami”)</i>
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	UNIEL dhe FSHMT disponojnë statistika vjetore të sakta për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit Master i Shkencave në “Mami”, tërheqjet dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të cdo viti akademik. Të dhënat menaxhohen nga sekretaria dhe sistemi EMS <i>(Evidenca .4.12 Rregullorja EMS, 3.7 Funkcionet dhe kompetencat e sekretarisë mësimore FSHMT; Vizita në Sekretarinë Mësimore)</i>
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Sistemi i brendshëm i informacionit në UNIEL i përfaqësuar nga dy strukturat përkatëse Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Drejtoria Ekonomike, menaxhon të dhënat statistikore të studentëve. Të dhënat janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar (sekretaria, pedagogët, IT) të cilët plotësojnë kriteret që përcaktohen nga ligji, për mbrojtjen e të dhënave personale. <i>(Evidenca 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL)</i>
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Sipas RVB dhe nga takimet e zhvilluara në Institucion, njësitë përkatëse të administratës në UNIEL, si edhe Dekanatit e Departamentit, mbështesin me akte përkatëse kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin: sekretarinë msimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, duke mundësuar vlerësimin dhe dokumentimin e gjendjes, saktësinë e informacionit dhe dokumentacionit që lidhet me studentët dhe veprimtarinë e tyre. Secili nga aktorët, ka akses në cdo kohë për vlerësimin apo kontrollimin e veprimtarisë administrative apo mësimore. <i>(Evidenca : 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL; 3.6 Rregullore për krijimin, ruajtjen, shërbimin dhe dorëzimin e</i>

	<i>dokumentave në UNIEL,; 3.7 Modalitetet e organizimit dhe funksioniit të sekretarisë arsimore të FSHMT; Vizita në Institucion)</i>			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Nga takimi në Departament, si dhe të dhënat e RVB, konkludojmë se, Departamenti analizon ecurinë e studentëve nga hyrja në dalje, si dhe harton raporte periodike mbi kalueshmërinë dhe cilësinë. Në sajë të bashkëpunimit që FSHMT ka me MISH, merr të dhëna mbi licensimin dhe punësimin e studentëve. Por kjo e dhënë nuk është e plotë për ALUMNI. Mbi bazën e këtyre treguesve, merren masa për përmirësimin e treguesve cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. <i>(Evidenca : 5.7 dhe Tabela 23. Të dhëna mbi punësimin e të diplomuarve.</i>			
Konkluzione	<i>RVB vlerëson së Standardi V.4 përmbushet kryesisht</i> UNIEL mbledh, administraton, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin dhe profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit Master i Shkencave në "Mami", nga pranimi deri në diplomim, si dhe bën përpjeke për grumbullimin e të dhënave mbi punësimin e tyre, të cilat duhet të jenë më të plota dhe më të sakta.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.5 Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Bazuar në Standardin e UNIEL, Rregulloren e FSHMT si dhe në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, studentëve u garantohet e drejta e përfaqësimit në organet e vendimmarrjes dhe këshilluese, Senatit Akademik, KIZ, KZF, NJSBC, RVB, komisioni i mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënies me studentët. Përfaqësuesi studentor, votohet dhe zgjidhet nga vetë studentët. Studentët zgjedhin përfaqësuesin e tyre edhe për Këshillin Studentor. <i>(Evidencat: 2.1 Lista e anëtarëve të Senatit akademik UNIEL; 2.2 Rregulloren e Këshillit Studentor)</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse	Nga takimi me studentët, si dhe nga analiza RVB, GVJ, vëren se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillimin dhe vlerësimin e procesit akademik është reale, konkrete, e verifikueshme dhe e matshme. Me studentët zhvillohen takime me transparencë të plotë dhe studentët ndjehen të vlerësuar. Në pyetësorët

dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	<p>që zhvillon periodikisht UNIEL, një zë i vecantë i takon edhe garantimit të pjesëmarrjes së studentëve në vendimmarrje.</p> <p><i>(Evidencat: 2.2 Rregullore e këshillit Studimor; 5.8 Vendim për Këshillin Institucional Zgjedhor; 5.10 Urdhri për komisionet e përhershme Institucionale në UNIEL; 2.1 Lista e Anëtarëve të Senatit Akademik UNIEL; 5.11 Urdhëri për komisionet e përhershme në Fakultet; 5.12 Urdhëri për grupin e punës për raportin e vetëvlerësimit për programet FSHMT; Takimi me studentët.)</i></p>			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	<p>Duke qënë aktor dhe faktor i rënësishëm për Departamentin, përmes anketave, pyetësorëve fizikë apo Google Form, departamenti garanton përfshirjen e tyre në procesin e hartimit, nënshkrimit dhe përmirësimit të programeve.</p> <p><i>(Evidencat: 6.2 Publikimi i raportit 2021-2022; 2.2 Rregullore e Këshillit Studentor; Takimi me studentët.)</i></p>			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	<p>Bazuar në Rregulloren e Studimeve FSHMT, studentët kanë të drejtë të njihen me rezultatet e provimeve, zgjidhjen e tezës, të ankimohen për rivlerësim, të rivlerësohen nga i njëjti komision apo nga komision tjetër. Këto janë hallka të një procesi transparent që aplikohet në Departament. Aktualisht, përdoret vlerësimi në formë shkresore, me teza të sekretuara nga një përfaqësues i Sekretarisë Mësimore. Në kuadër të marrëveshjes për implementimin e CLEAN SCORE, procesi i vlerësimit do të jetë më transparent.</p> <p><i>(Evidenca: 1.7 Rregullore e FSHMT; 1.8 Rregullore e Programit të studimit “Master I Shkencave në Mami” 3.4 Marrëveshja e implementimit CLEAN SCORE.)</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ, vlerëson se, Standardi V.5 përmbushet kryesisht.</i></p> <p><i>UNIEL përfshin dhe organizon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit Master i Shkencave në “Mami”, por vihet re një indiferencë nga ana e studentëve për të qënë të angazhuar dhe kjo dëmton procesin. Duke vendosur ura më të mira komunikimi për rritjen e cilësisë së burimeve dhe shërbimeve ndaj tyre.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>Në shërbim të informimit të studentëve GVJ konstaton se, UNIEL ve në dispozicion njësi të posaçme të informimit dhe shërbimit: Zyra e IT, zyra e Financës, Zyra e Kurrikulave, Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, Zyra e Këshillimit dhe Karrierës dhe ALUMNI. UNIEL ve në dispozicion të studentëve rubrikën e transparencës, sipas një programi online të miratuar.</p> <p><i>(Evidencat: 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL; 2.4 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për studentët dhe Këshillimin e Karrierës.)</i></p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>GVJ vëren se, informimi, këshillimi dhe ndjekja e përparimit të studentëve është kompetencë dhe detyrim i Shefit të Departamentit dhe pedagogëve të moduleve përkatëse. Gjithashtu sistemi EMS vihet në dispozicion për të gjithë studentët.</p> <p><i>(Evidencat: 4.12 Rregullorja EMS; 2.12 Programet lëndore të Programit të studimit Master i Shkencave në “Mami”)</i></p>			
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>UNIEL u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës, nëpërmjet Zyrës së Këshillimit e Karrierës dhe ALUMNI. Studentët informohen dhe orjentoohen për kompletimin e procesit mësimor, për praktikën profesionale dhe tregun e punës.</p> <p><i>(Evidencat: 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit të UNIEL; 2.4 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për studentët dhe Këshillimin e Karrierës.)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>UNIEL u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës, nëpërmjet Zyrës së Këshillimit e Karrierës dhe ALUMNI. Studentët informohen dhe orjentoohen për kompletimin e procesit mësimor, për praktikën profesionale dhe tregun e punës.</p> <p><i>(Evidencat: 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit të UNIEL; 2.4 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për studentët dhe Këshillimin e Karrierës.)</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ, vlerëson se, Standardi V.6 përbushet plotësisht.</i></p> <p><i>UNIEL ka procedura dhe njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, si edhe menaxhimin e problematikave. Këto njësi janë të përherëshme dhe lehtësisht të arritshme nga studentët.</i></p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Në përshtatjen me kërkesat e kohës, UNIEL harton udhëzues që nxisin zhvillimin me mjete të tilla si: Mësimdhënia në distancë, apo të mësuarit me qëndër studentin, përdorimi i mjeteve bashkëkohore dhe metodave inovative janë bërë praktikë edhe në Programin e Studimit Master i Shkencave në “Mami”. <i>(Evidencat: 6.1 Guida e pedagogut Mësimi online nëpërmjet Microsoft Teams)</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	DSTM, Dekanati i FSHMT, si dhe njësitë përkatëse të vlerësimit dhe monitorimit të personelit akademik dhe ndihmës akademik si Drejtoria e Kurrikulave dhe e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, bëjnë të mundur që përmes pyetësorve apo pjesmarrjes në veprimtari kërkimore-shkencore, vlerësojnë periodikisht mbi metodat inovative që aplikohen gjatë procesit mësimor. <i>(Evidencat: 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022; 5.10 Urdhri për Komisionet e përhershme Institucionale në UNIEL; 5.11 Urdhri për Komisionet e përhershme në Fakultet)</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	UNIEL, në nivel institucional ka ngritur Sektorin e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i cili bazuar në ligj dhe aktet nënligjore, harton pyetësorin e studentëve për matjen e performancës, për cilësinë e mësimdhënies në cdo program studimi. Kjo njësi mbështetet edhe nga Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë, një anëtar i të cilit është student, në nivel Universiteti e Fakulteti. <i>(Evidencat: 1.1 Statuti i UNIEL; 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022; 5.10 Urdhri për Komisionet e përhershme Institucionale në UNIEL; 5.11 Urdhri për Komisionet e përhershme në Fakultet)</i>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Pyetësori i përgatitur nga Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i plotësuar nga studentët në cdo fund semestri, analizohet nga strukturat përgjegjëse. Raporti publikohet edhe në faqen zyrtare të UNIEL.

	<i>(Evidenat: 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022; 1.3 Strategjia e UNIEL; 1.3.1 Strategjia e FSHMT)</i>			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Bazuar në RVB, dhe takimet në institucion, UNIEL, në veçanti NjSBC, vlerëson rezultatet e përfuara nga pyetësorët, raportin e analizës vjetore të fakultetit dhe universitetit dhe bën publikimin në faqen zyrtare të UNIEL. Veprimtaritë dhe praktikat më të mira si leksione të hapura, workshope, aktivitete të tjera i publikon si modele në faqen zyrtare. <i>(Evidenca: 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022)</i>			
Konkluzione	<i>GVJ, mendon se standardi VI.1 përmbushet plotësisht. UNIEL ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton undhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimet.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe me aktet rregullatore institucionale, UNIEL ka hartuar rregulloren, në të cilën përcaktohen rregullat për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përhershëm për garantimin e Standardeve të Cilësisë. <i>(Evidencat: 1.1 Statuti i UNIEL; 1.3 Strategjia e UNIEL; 1.3.1 Strategjia e FSHMT; 5.16 Rregullore e NjSBC të FSHMT)</i>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Në përputhje me Standardet Shtetërore të cilësisë, të parashikuara në Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë, si dhe në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë elementet e programeve të studimit të ofruara nga UNIEL, është ngritur dhe funksionon Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë, i përbërë nga anëtarë të personelit akademik dhe studentë, i cili ka për qëllim garantimin e Standardeve të Cilësisë së UNIEL dhe Programeve të Studimit. <i>(Evidencat: 6.8 Rregullore e NjSBC; 1.1 Statuti i UNIEL; 1.3 Strategjia e UNIEL, Tabela 24 Të dhëna për anëtarët e NJSBC)</i>

<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>GVJ, gjen se, Sigurimi i brendshëm i cilësisë realizohet nëpërmjet procesit të vlerësimit të brendshëm institucional ose të programeve të studimit. Instrumentat e përdorur janë pyetsorët për vlerësimin e studentëve, anëtarëve të stafit akademik, vetëvlerësimi i pedagogëve e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënit.</p> <p>Për sigurimin e vlerësimit të jashtëm të cilësisë, UNIEL bashkëpunon me ASCAL për vlerësimin e programeve të vecanta apo edhe në rang institucioni. UNIEL i është nënshtruar dy herë procesit të akreditimit institucional. Në vlerësimin e fundit është akredituar maksimalisht me 6 vite</p> <p><i>(Evidencat: 1.6 Certifikata e Akreditimit Institucional; 6.6 Raporti i vetëvlerësimit për akreditimin Institucional; 6.8 Rregullore e NjSBC.)</i></p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>UNIEL, nëpërmjet NjSBC, si njësi e posaçme përdor tregues të qartë dhe të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim. NjSBC mbikqyr hartimin e programeve dhe planeve mësimore, disiplinave mësimore, si dhe harmonizimin e tyre. Periodikisht rishikohen dhe përmirësohen programet ekzistuese. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bëri promovime për arritjet më të mira.</p> <p><i>(Evidencat: 6.2 Pubikimi i Raportit 2021-2022; 6.6 Raporti i Vetëvlerësimit të Brendshëm për Akreditimin Instutcional.)</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ, vlerëson se, Standardi VI.2 përmbushet plotësisht.</i></p> <p><i>UNIEL harton dhe zbaton politika dhe procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit Master i Shkencave në "Mami" në kuadër të strukturave të sigurimit të brendshëm të cilësisë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e</p>	<p>Në UNIEL zhvillon aktivitetin e vet, Drejtorja e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë, e cila mbulon aspektet kurrikulare dhe ato të sigurimit të cilësisë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe me Statutin e UNIEL. Kjo njësi orienton, monitoron dhe vlerëson programet e studimit. Rezultatet e vlerësimit të cilësisë përfshihen në Raportin Vjetor të FSHMT dhe UNIEL.</p>

<p>arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p><i>(Evidencat: 1.12 Analiza vjetore institucionale 2021-2022; 1.12.1 Analiza vjetore e DSTM 2020-2021; 6.6 Raporti i Vetvlersimit të Brendshëm për Akreditimin Institucional)</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Sipas RVB, Departamentet e FSHMT dhe Dekanati i FSHMT, në fund të vitit akademik, përgatisin analizën vjetore të fakultetit të cilën ja dërgojnë Senatit të UNIEL. Komunikimi i këtij informacioni në Senatin Akademik krijon mundësi të mirë për të përmirësuar dhe garantuar rritjen e cilësisë së programeve të studimit.</p> <p><i>(Evidencat: 1.12 Analiza vjetore institucionale 2020-2021; 1.12.1 Analiza vjetore e DSTM 2020-2021; 1.12.2 Raport për veprimtaritë e programit të studimit.)</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinsticionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Bazuar në Rregulloret dhe Strukturat përkatëse, UNIEL përdor metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin dhe mbarëvajtjen e cilësisë së programit. Instrumentat dhe metodat e përdorura nga NjSBC, Zyra e Marrëdhënive me Jashtë, Zyra e Këshillimit dhe Karrierës, si dhe Departamenti janë vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies, vlerësimi i didaktikës, kurrikulës, vëzhgime në auditor. Në RVB përmendet se ka vlerësime paralele, por ne nuk kemi evidencë për to. Gjithashtu, nuk ka evidencë për testime lokale apo të standartizuara, rezultate të arritura në testime ndërinsticionale apo kombëtare, si provimi i shtetit, etj. Në departament zhvillohen orë të hapura, çka flet për përpjekjen në rritjen e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p><i>(Evidencat: 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL; 1.7 Rregullore e FSHMT; 1.8 Rregullore e programit të studimit "Master I Shkencave në Mami; 1.15 Korniza konceptuale e programit të studimit.)</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e</p>	<p>Ndër metodat e instrumentat e tërthortë që UNIEL përdor për vlerësimin e cilësisë, në RVB, por edhe nga takimet në Institucion përmendet kryerja e pyetsorëve anonimë , rezultatet e të cilave përpunohen nga Sektori i Kurrikulave dhe i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe rezultatet pasyrohesh në Raportin Final. ALUMNI mbledh të dhëna në mënyrë periodike, por ky burim ngelet të përmirësohet në të ardhmen.</p> <p><i>(Evidencat: 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022; Tabela 23. Të dhëna mbi diplomimin dhe punësimin e të diplomuarve. Vizita në Institucion.)</i></p>

programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfuara nga ky program.				
Konkluzione	<i>GVJ, konstaton se ky standard përmbushet kryesisht. UNIEL monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme, programin e studimit Master i Shkencave në "Mami", me qëllim që të garantojë arritjen e objektivave formues dhe të rezultateve të pritshme të të nxënës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitet akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	FSHMT ka njësinë e tij përkatëse të SBC, e cila përbëhet nga pesë anëtarë: katër anëtarë vijnë nga personeli akademik dhe njëri anëtar është përfaqësues i studentëve. Anëtarët e komisionit, përfaqësues të Universitetit, vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik i UNIEL, me një mandate dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. <i>(Evidencat: 6.8 Rregullore e NjSBC.)</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitet, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Bazuar në Rregulloren e UNIEL dhe NjSBC, çdo department ka përfaqësuesin e vet në NjSBC, i cili ka detyrë adresimin konkret të problematikave të njësisë bazë. Komunikimi me studentët realizohet drejtpërdrejt si komunikim pedagog-student, apo indirekt falë pyetësorëve periodikë, të cilët shpërndahen për studentët në periudhën Janar-Qershor të çdo viti akademik. <i>(Evidencat: 1.4 Rregullore e organizimit dhe funksionimit UNIEL; 6.8 Rregullore e NjSBC; 6.7 Rregullore për Funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Standardet e Cilësisë.)</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative	Kuadri ligjor garanton dhe kërkon përfshirjen e Departamentit dhe të anëtarëve të FSHMT në procesin e sigurimit të cilësisë. <i>(Evidencat: 1.1 Statuti UNIEL; 1.4 Rregullore e UNIEL; 2.4 Rregullore për funksionimin e komisionit të përhershëm për studentët dhe Këshillimin e karrierës; 6.8 Rregullore e NjSBC;)</i>

dhe studentëve të programit të studimit.									
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Në RVB citohet, se procedura e vlerësimit të brendshëm i nënshtrohet Kodit të Etikës, të miratuar në UNIEL. Parimi bazë që udhëheq procesin e vlerësimit është respektimi i integritetit akademik dhe shmangia e çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. Në UNIEL është ngritur një strukturë e posaçme në mbrojtje të të drejtave të studentëve. <i>(Evidencat: 6.5 Kodi i Etikës UNIEL; 2.4 Rregullore për funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Studentët dhe Këshillimin e Karrierës.)</i>								
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	NjsBC administron, organizon dhe përgatit vizita të vlerësimit të jashtëm ose fton ekspertë të jashtëm për të trajnuar stafin që merret me vlerësimin e brendshëm. Në kuadrin e vlerësimit institucional dhe akreditimit të programeve të studimit, janë zhvilluar takime me ekspertë ndërkombëtarë dhe vendas të përzgjedhur nga ASCAL dhe Bordi i Akreditimit. <i>(Evidencat: https://www.uniel.edu.al njoftime.un...akreditimit-institucional)</i>								
Konkluzione	<i>GVJ, vëren se, ky standard përmbushet plotësisht. UNIEL përfshin njësitë akademike, personelin akademik dhe studentët në proceset e SBC dhe informon për rezultatet, palët e interesuara në këtë proces.</i>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë që UNIEL organizon në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përmbledhen në Raportin vjetor, të cilin UNIEL e publikon për të gjithë të interesuarit përfshirë edhe studentët. <i>(Evidenca: 6.2 Publikimi i raportit 2021-2022)</i>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe	Rezultatet e vlerësimit të programeve të studimit përmbledhen në raportin vjetor përfundimtar, që NjsBC ia përciell Rektorit dhe Senatit Akademik për veprime të mëtejshme. Përmbledhja e Raportit publikohet pa emra

etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	konkretë mbështetur mbi ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Problematikat e evidentuara analizohen dhe diskutohen në mbledhjen e Senatit Akademik, për të adresuar zgjidhjet specifike. <i>(Evidencat: 6.2 Publikimi i raportit 2021-2022; 6.5 Kodi i Etikës.)</i>			
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Raporti vjetor i NjsBC të FSHMT, si dhe plan-masat e sugjeruara nga Fakulteti, si pjesë e raportit të UNIEL, diskutohen në Senatin Akasemik i vili nxjerr vendim me masat dhe rekomandimet përkatëse në drejtim të përmirësimit të cilësisë. <i>(Evidencat: 6.2 Publikimi i Raportit 2021-2022; 6.6 Raport i vetëlerësimit të brendshëm për akreditimin Institucional-UNIEL.)</i>			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	UNIEL nëpërmjet strukturave të veta, Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit siguron efektivitetin e veprimtarive. NjsBC vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore e shkencore dhe harton raportet përkatëse të Vlerësimit të Brendshëm. Të dhënat e Vlerësimit përdoren për përmirësimin e cilësisë së progrmit të studimit, përmirësimin e shërbimeve dhe performancës së personelit akademik e ndihmësakademik, për planifikimin vjetor e strategjik. <i>(Evidencat: 6.6 Raporti i Vetëvlerësimit për akreditimin institucioal; 6.2 Publikimi i raportit 2021-2022,)</i>			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	NjsBC organizon takime periodike me anëtarët e saj, stafi dhe studentët e interesuar njihen me konkluzionet e takimeve, ndërkohë që UNIEL ka zhvilluar takime me përfaqësues të ASCAL, duke mundur informimin dhe ndërgjegjësimin e personelit dhe studentëve, për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programeve të studimit dhe konkretisht të programit Master i Shkencave në “Mami”. <i>(Evidenca: 6.8 Rregullore e NjsBC.)</i>			
Konkluzione	<i>GVJ, konkludon se, standarti VI.5 realizohet plotësisht.</i> <i>UNIEL harton dhe kryen politika, procese dhe veprimtari për sigurimin e brendshëm të cilësisë për programin e studimit Master i Shkencave në “Mami” të cilat janë publike transparente dhe efektive, me synimin e krijimit të kulturës së brendshme.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Konkluzione mbi Vlerësimin e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Mami” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan

Pikat e forta

1. Programi synon të ruajë vlerat arsimore, shëndetësore e kulturore kombëtare, të nxisë promovimin e tyre dhe kultivimin e qëndrimeve pozitive multikulturore, përmes mundësisë së përfshirjes në program të studentëve shqiptarë dhe studentëve nga vende të tjera.
2. Institucioni identifikon nevojat për kualifikim të stafit akademik dhe inkurajon për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.
3. GVJ e konsideron pikë të fortë infrastrukturën që disponon institucioni për realizimin e praktikës mësimore (laboratorin dixhital të anatomisë humane, laboratorin biokimik klinik, laboratorët e procedurave infermieristike të paisur me manekinë pediatrikë dhe adultë për kryerjen e procedurave infermiere, manekinë simulatorë në dispozicion të studentëve të gjithë programeve të studimit në infermieri), të cilat ndihmojnë në praktikimin e aftësive dhe njohurive të marra nga studentët.
4. Organizimi i aktiviteteve shkencore në kuadër të Fakultetit me studentët, me bazë bashkëpunimi staf akademik-student.
5. Planet dhe programet mësimore janë hartuar në bazë të modeleve më të mira kombëtare, europiane e më gjerë duke respektuar standartet dhe kuadrin ligjor në fuqi. Aktiviteti mësimor në këtë program studimi fokusohet jo vetëm në shkencën e obstetrikë gjinekologjisë, por dhe në fushën e menaxhimit dhe organizmit shëndetësor si dhe në metodologjinë e kërkimit shkencor.
6. Programi i studimit ka një ndërthurje harmonike të koncepteve teorike me praktikën në auditor dhe praktikën profesionale. Praktika është një pjesë e rëndësishme e planit mësimor në këtë program studimi. Avantazh për zhvillimin e praktikës është vendosja e universitetit në territorin e spitalit rajonal të Elbasanit dhe marrëveshjet e bashkëpunimit me këtë institucion dhe institucione të tjera shëndetësore. Studentët që diplomohen në këtë program studimi janë të aftë të punojnë në konsultore, dhe në shërbimet spitalore në sektorin e obstetrikë-gjinekologjisë.
7. Institucioni ka bashkëpunim dhe marrëveshje me struktura universitare europiane, veçanërisht me universitetet italiane të Aquila dhe Bari, që kanë ndikuar pozitivisht në mobilitetin e stafit akademik, kualifikimin e tij dhe organizimin e konferencave shkencore.
8. GVJ konstatoi organizim të mirë dhe mirëmenaxhim në nivel institucional.

9. Institucioni ka një politikë mbështetëse dhe inkurajuese për studentin.

Pikat e dobëta

1. Shpërndarja e ngarkesës mësimore në disa raste nuk përputhet me kërkesat ligjore. Kjo lidhet dhe me numrin e vogël të personelit akademik me titujt Prof. dhe Prof. Asc. Ka pedagogë që japin lëndë që nuk përputhen me ekspertizen dhe formimin e tyre profesional, një pedagog jep më shumë se tre lëndë dhe ngarkesa mësimore e PAE është mbi normën e parashikuar nga legjislacioni në fuqi. Ka Lektorë pedagoge të kategorisë Msc, ku legjislacioni përcakton që lektorët duhet të zotërojnë gradën “Doktor i Shkencave”. Disa nga titullarët e lëndëve nuk janë te kategorisë Profesor (kërkesë e Ligjit të Arsimit të Lartë).
2. Cilësia e studentëve e kushtëzuar nga pranimi pa konkurs dhe pa kritere specifike.
3. Fondi i limituar i bibliotekës për këtë program studimi dhe nevoja për përditësim të literaturës.
4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstatoi se ka përfunduar afati ligjor i marrëveshjeve të bashkëpunimit.

Rekomandime

1. Mbështetja dhe promovimi i kërkimit shkencor nga pedagogët që do të kontribuojë direkt në përmirësimin e ofertës akademike dhe cilësisë së mësimdhënies.
2. Rritja e marketingut dhe reklamës së programit të studimit për tërheqjen e një numri më të madh studentësh cilësorë.
3. GVJ rekomandon rishikimin e shpërndarjes së veprimtarive formuese në përshtatje me udhëzimin e përcaktuar në VKM-në 41 datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e arsimit të lartë”.
4. GVJ rekomandon përditësimin e literaturës bazë të detyruar dhe ndihmëse.
5. GVJ rekomandon përshtatjen e ngarkesës mësimore në përputhje me Ligjin 80/2015 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe Udhëzimin 29 të MASR, datë 10/09/2018
6. GVJ rekomandon rinovimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit midis UNIEL dhe institucioneve shëndetësore.
7. Vazhdimi i investimeve në infrastrukturë dhe teknologji për të përmirësuar ofertën mësimore dhe shërbimet për studentët.



8. Rekrutimi i stafit akademik me tituj dhe grada si dhe mbështetja e stafit ekzistues për përmbushjen e objektivave të kualifikimit për fitimin e gradave dhe titujve shkencorë. Hapja e programit të ciklit të tretë të doktoraturës mund të japë një kontribut në përmirësimin e ofertës akademike.
9. Përmirësimi i bashkëpunimit ndërkombëtar duke synuar përfshirjen e stafit akademik në projekte kërkimore-shkencore të përbashkëta.
10. Rinovimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me strukturat spitalore dhe shëndetësore lokale në funksion të realizimit të praktikës profesionale.
11. Standartizimi dhe përmirësimi i proceseve që lidhen me vlerësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe programit të studimit.

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Nurse Midwife" provided by the Higher Education Institution University "Aleksandër Xhuvani" Elbasan

Strengths and affirmations

1. The program aims to preserve educational, health and national cultural values, to promote them and also to cultivate a multicultural approach, through the possibility of inclusion in the program in addition to Albanian students and students from other countries.
2. The institution identifies the needs for professional development of the academic staff and encourages the continuous qualification of its personnel.
3. The External Evaluation Group considers the institutional infrastructure for the realization of teaching practice to be a strong point (digital laboratory of human anatomy, clinical biochemical laboratory, laboratories of nursing procedures equipped with pediatric and adult mannequins for performing nursing procedures, simulator mannequins available to students of all programs of study in nursing), which help to practice the skills and knowledge acquired by students.
4. Organization of scientific activities within the faculty with students, based on academic staff-student cooperation.
5. Educational plans and programs are designed based on the best national, European and other international models, respecting the standards and legal framework in force. The teaching activity in this study program focuses not only on the science of obstetrics and gynecology, but also on the field of management, health organization and scientific research methodology.

6. The study program has a harmonious combination of theoretical concepts with classroom and professional practice. Practice is an important part of the curriculum. Advantage for the development of the practice is the placement of the university in the territory of the regional hospital of Elbasan and the cooperation agreements with this institution and other health institutions with which the cooperation agreements were renewed. Students who graduate from this study program are able to work in consultancies, and in hospital services in the obstetrics-gynecology sector.
7. The institution cooperates and has signed agreements with European university structures, especially with the Italian universities of Aquila and Bari, which have had a positive impact on the mobility of academic staff, their qualification and the organization of scientific conferences.
8. The External Evaluation Group noted good management at the institutional level.
9. The institution practices a supportive and encouraging policy for the student.

Weaknesses

1. The distribution of the teaching load in some cases does not comply with the legal requirements. This is also related to the small number of academic staff who have earned the scientific titles of Prof. and Prof. Asc. There are lecturers who teach subjects that do not match their expertise and professional training, a lecturer teaches more than three subjects and the teaching load of the effective academic staff is above the teaching load provided by the legislation in force. There are pedagogic lecturers of the Msc category, where the legislation stipulates that the lecturers must possess the degree of "Doctor of Science". Some of the heads of the subjects are not included in the Professor category (requirement of the Albanian higher education law).
2. The quality of the students, which is conditioned by admission to the university without competition and without specific criteria.
3. The library's limited book fund for this study program and the need to update the literature.
4. The External Evaluation Group, based on the review of the documentation, found that the legal term of the cooperation agreements with some of the cooperating institutions has ended.

Recommendations

1. Greater support and promotion of scientific research by lecturers that will directly contribute to improving the quality of teaching.
2. Increased marketing and advertising for the degree program to attract more quality students.
3. The External Evaluation Group recommends the review of the distribution of the component elements of the study program in accordance with the guidelines defined in the Decision of the Council of Ministers no. 41, dated 24.01.2018 "On the elements of study programs offered by higher education institutions".
4. The External Evaluation Group recommends updating the mandatory core and ancillary literature.
5. The External Evaluation Group recommends adapting the teaching load in accordance with Law 80/2015 "On Higher Education in the Republic of Albania" and Instruction No. 29 of the Ministry of Education and Sports, dated 10/09/2018.
6. The External Evaluation Group recommends the renewal of cooperation agreements between the University of Elbasan "Aleksander Xhuvani" and several health institutions within the country.
7. Continuation of investments in infrastructure and technology in order to improve the quality of teaching and learning and also services for students.
8. Recruitment of academic staff with academic titles as well as support of the existing staff to fulfill the objectives of further academic qualification. The opening of the third cycle doctoral program can make a contribution to the improvement of the academic offer.
9. Improving international cooperation aiming at the involvement of academic staff in joint research-scientific projects.
10. Renewal of cooperation agreements with the local hospital and other local health structures in function of the realization of professional practice by students.
11. Standardization and improvement of processes related to the continuous evaluation of the quality of teaching and the study program, as well.

Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT			X	
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X